



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Kohezioni Social në Kosovë: Shqyrtimi i kontekstit dhe pikave hyrëse

Korrik 2019

Mendimet e shprehura në këtë raport nuk i përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ose Folke Bernadotte Academy (FBA).

1. HYRJE	4
2. KONTEKSTI AKTUAL NË LIDHJE ME KOHEZIONIN SOCIAL NË KOSOVË - GJETJET KYÇE NGA HULUMTIMI I UNDP/FBA.....	7
Tema 1: Cilësia e udhëheqjes politike	14
Tema 2: Stagnimi në raport me ekonominë, qeverisjen dhe shërbimet sociale	16
Tema 3: Mundësitë e bashkimit për ndryshime pozitive	17
Aktorët kyç dhe dinamikat e mëtejme të theksuara nga hulumtimi	19
<i>Tjetërsimi i rinisë.....</i>	<i>19</i>
<i>Barazia gjinore</i>	<i>20</i>
<i>Komuniteti ndërkombëtar dhe roli i tij</i>	<i>20</i>
<i>Feja si faktor</i>	<i>21</i>
3. PUNËTORITË E VËRTETIMIT TË GJETJEVE TË HULUMTIMIT/RAPORTIT	22
Pikat hyrëse sektoriale	23
<i>(i) Mediat</i>	<i>23</i>
<i>(ii) Sektori i drejtësisë.....</i>	<i>24</i>
<i>(iii) Angazhimi i aktorëve kyç.....</i>	<i>24</i>
SHTOJCA 1 - PROJEKTET E UNDP-së NË KOSOVË.....	27
SHTOJCA 2 - AGJENDA E PUNËTORISË.....	31
SHTOJCA 3 - PUNËTORITË E VALIDIMIT TË GJETJEVE TË HULUMTIMIT/RAPORTIT	33
SHTOJCA 4 - AGJENDA E PUNËTORISË PËR VËRTETIM TË GJETJEVE	37

1. HYRJE

Marrë parasysh tensionet në rritje në rajonin e Ballkanit Perëndimor në përgjithësi dhe në Kosovë¹ në veçanti, analiza e shkaqeve dhe pikave potenciale të ndezjes së konfliktit, si dhe identifikimi i rrezeve e poashtu edhe i mundësive për programimin e kohezionit social, janë bërë shumë më të rëndësishme.² Në vitin 2012 nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) u realizua një analizë zhvillimore për Kosovën e lidhur me konfliktin, por prej atëherë nuk është përditësuar; dhe ka hulumtime të kufizuara në dispozicion nga burime të tjera që i hulumtojnë dinamikën dhe çështjet e konflikteve. Zhvillimet politike, veçanërisht që nga viti 2012, bëjnë thirrje për një shqyrtim të dinamikës dhe shkaqeve të mundshme, si dhe të pikave hyrëse për ndryshime konstruktive. Kjo analizë është ndërmarrë me qëllim të zgjerimit të këndvështrimit të UNDP-së, si dhe të komunitetit më të gjerë të OKB-së dhe palëve të interesit, mbi dinamikën e konfliktit në Kosovë, përmes një procesi të analizës së kohezionit social me shumë palë të interesit.

Në situata që nuk janë në konflikt të hapur të armatosur, por ku qytetarët dhe aktorët politikë po merren me trashëgimitë e cikleve të mëparshme të dhunës; ose ku apetitet politike për të folur për ndërtimin e paqes ose pajtimin janë të ulëta, puna për avancimin e kohezionit social mund të sigurojë një bazë të rëndësishme për të kontribuar në qëllimin më të gjerë të agjendës së Mbështetjes së Paqes, të vendosur nga Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Ndërtimin e Paqes dhe Mbështetjen e Paqes, ose Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) 16, mbi 'paqen, drejtësinë dhe gjithëfshirjen'. Koncepti është përkufizuar nga UNDP-ja si:³

*'Një veti e shoqërisë që e reflekton shkallën e besimit, ndërvarësisë dhe shkëmbimit ekonomik si dhe ndërveprimet ndërpersonale, së bashku me ndjenjën e fatit të njëjtë ose të përbashkët. Kohezioni social çon në gatishmërinë për të marrë pjesë kolektivisht në kërkimin e qëllimeve të paqes dhe objektivave të përbashkëta të zhvillimit, dhe për të bashkëpunuar dhe për t'u angazhuar me shtetin në forcimin e ndërsjellë të marrëdhënieve të besimit dhe besnikërisë në mes të shtetit dhe shoqërisë.'*⁴

Ky punim i bën bashkë gjetjet e një serie të tërë punëtorish të mundësuar, të cilat kishin për qëllim të kapnin këndvështrime dhe dimensione të ndryshme relevante për kohezionin social në Kosovë, gjë që u zhvilluan në tetor 2018, së bashku me literaturën dytësore dhe analizat. Këto u ndërmorën përmes partneritetit në mes të UNDP-së dhe Akademisë Folke Bernadotte (FBA). FBA-ja e mbështeti procesin e punëtorive të udhëhequra nga UNDP-ja, duke siguruar planifikimin e punëtorive, dizajnin dhe mbështetjen e mundësimit të hapësirave, si dhe mbështetjen financiare për procesin. Bashkëpunimi ishte pjesë e bashkëpunimit më të gjerë të FBA-së me OKB-në, veçanërisht me Programin e Përbashkët të UNDP-DPA mbi Forcimin e Kapaciteteve Kombëtare për Parandalimin e Konflikteve.

¹ Referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

² Shih për shembull: Përfaqësuesi Special i thotë Këshillit të Sigurisë se rritja e tensioneve mes Prishtinës dhe Beogradit kërcënon përpjekjet për firkëtimin e paqes së qëndrueshme në Kosovë, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. 14 maj 2018, <https://www.un.org/press/en/2018/sc13335.doc.htm>.

³ UNDP ka një numër nismash programimi që janë dizajnuar për të kontribuar në kohezionin e përmirësuar social dhe paqen e qëndrueshme në Kosovë, nën dritën e Objektivit 16 për Paqen, Drejtësinë dhe Institucionet e Forta, të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Angazhimi i mëparshëm ka konsistuar në një sërë ndërhyrjesh të suksesshme, si pjesë e qeverisjes dhe ndërtimit të paqes; mjedisi, klima dhe përrirja pas fatkeqësive; dhe portfoliot e zhvillimit të qëndrueshëm. Këto përmbliohen në Shtojcën 1 të këtij dokumenti.

⁴ UNDP (botohet së shpejti). *Forcimi i Kohezionit Social për Mbështetjen e Paqes - Një Shënim Udhëzues për Vlerësimin dhe Praktikën*.

Duke mbledhur ekspertë, praktikues, anëtarë të publikut, shërbyes civilë dhe përfaqësues të OSHC-ve, metodologjia për punëtoritë u ndërtua duke u bazuar në përkufizimin e UNDP-së për kohezionin social (më lart), dhe u përqendrua në identifikimin si të *bashkuesve* ashtu edhe të *ndarësve* që lidhen me kohezionin social në Kosovë, si dhe në bazat e mundshme për forcimin e kohezionit social dhe skenarët e mundshëm në të ardhmen.⁵ Përmbajtja e punëtorive u zhvillua nga FBA-ja, dhe u ndërtua mbi ushtrimet interaktive dhe diskutimet e mundësuar. Punëtoritë synonin që t'i identifikonin pikat e forta dhe të dobëta në kontekstin aktual në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me besimin, ndërvarësinë, shkëmbimin ekonomik dhe ndërveprimet ndërpersonale. Punëtoritë e mundësuar u mbajtën në rajonet komunale të Mitrovicës, Gjilanit dhe Prishtinës, për të pasqyruar këndvështrime të ndryshme nga rajone të ndryshme gjeografike dhe pikëpamjet e etnive të ndryshme.

Korniza e diskutimit të punëtorive dhe pyetjet kyçe kishin si synim:

- *Reflektimin mbi shkallën e besimit, ndërvarësinë, shkëmbimin ekonomik dhe ndërveprimet ndërpersonale që ekzistojnë në Kosovë*
- *Hulumtimin e dimensioneve horizontale dhe vertikale të kohezionit social dhe të barrierave ndaj tij*
- *Të kuptuarit e bashkuesve që çojnë në gatishmërinë për të marrë pjesë kolektivisht në kërkimin e qëllimeve të përbashkëta të paqes dhe zhvillimit.*

Në punëtori morën pjesë gjithsej 32 persona që përfaqësonin institucionet e Kosovës, shoqërinë civile, përfaqësues të komunitetit dhe organizata ndërkombëtare. Edhe pse në numër të vogël në përgjithësi, pjesëmarrësit demonstroi një nivel të lartë të angazhimit gjatë diskutimeve veçanërisht në Prishtinë dhe Mitrovicë, ku numri i pjesëmarrësve ishte më i lartë (me vetëm 8 pjesëmarrës të mobilizuar në Gjilan). Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve ishin gra. Në Mitrovicë, shumica e pjesëmarrësve përfaqësonin komunitetin serbisht-folës, dhe në punëtoritë e tjera, shumica e përfaqësonin komunitetin shqip-folës. Në punëtori mungoi pjesëmarrja e pakicave të tjera kosovare. Të pranishëm ishin edhe një numër i përfaqësuesve nga komuniteti ndërkombëtar. Një numër i vogël i pjesëmarrësve përfaqësuan rininë. Asnjë përfaqësues fetar nuk ishte i pranishëm në asnjërën prej punëtorive.⁶

Ndërkohë që të tri punëtoritë ndryshonin në përbërje, si në numër ashtu edhe në përfaqësim, disa ushtrime u ndryshuan paksa për t'iu përshtatur madhësisë së audiencës. Sidoqoftë, formati themelor ishte që secila punëtori të fillonte me një ushtrim të fasiltuar (të mundësuar përmes fasilituesit), duke prezantuar një numër pyetjesh, duke hulumtuar me pjesëmarrësit ku ishte kohezioni social më i fortë dhe ku më i dobët; ku e shihnin pjesëmarrësit gatishmërinë më të madhe për ta forcuar kolektivisht besimin mes të gjithë kosovarëve dhe institucioneve të vendit; dhe cilët aktorë ishin më të rëndësishmit për ta forcuar kohezionin social në Kosovë. Kjo u pasua nga një diskutim i fasiltuar i skanimit të kontekstit mbi kohezionin social në Kosovë, me qëllim që bashkërisht të diskutoheshin aspekte të rëndësishme të kohezionit social. Një sesion ku u

⁵ *Udhëzimet dhe procedurat në terren për analizën e konflikteve*, Partneriteti Global për Parandalimin e Konfliktit të Armatosur, 2016

⁶ Shih Agjendën në Shtojcën 2.

prezantua studimi i kërkuar dhe i mundësuar nga UNDP-ja për kohezionin social, së bashku me një diskutim nga autori dhe një mundësi që pjesëmarrësit të analizonin, përgjigjeshin dhe parashtronin problematika rreth gjetjeve të hulumtimit. Në vijim, u mbajt një sesion pune në grupe me qëllim të identifikimit të njohurive si për faktorët e rrezikut ashtu edhe për mundësitë për ta avancuar kohezionin social. Puna në grup u pasua nga një diskutim plenar dhe një përpjekje për t'i diskutuar skenarët e mundshëm në të ardhmen.

Procesi u plotësua më tej nga një numër takimesh më të vogla bilaterale, të mbajtura paralelisht me punëtoritë. Këto takime përfshinin institucionet qendrore në Prishtinë, përfaqësues nga shoqëria civile, academia, komunitete fetare dhe vëzhgues politikë. Ky raport gërsheton diskutimet e punëtorive me literaturën burimore sekondare dhe analizat e disponueshme për t'i kryqëzuar dhe për ta ndërtuar një pamje më të madhe. Raporti gjithashtu buron nga një studim mbi kohezionin social në Kosovë të kërkuar dhe të mundësuar nga UNDP-ja, një analizë mbi Parandalimin e Konfliktit/Kohezionin Social të ndërmarrë nga Zyra Rajonale e UNDP-së në Stamboll (IRH) në komunat veriore në Kosovë⁷, së bashku me punën e mëparshme mbi analizën zhvillimore që lidhet me konfliktin të ndërmarrë nga UNKT dhe të mbështetur më tej nga literatura mbi mjedisin politik dhe dinamikën e konfliktit në Kosovë.

Duke qenë se fushëveprimi i konsultimeve ka qenë i kufizuar, ky punim ofrohet si një tablo që rrjedh nga metodologjia e përdorur. Ndërkohë që përfundimet e paraqitura nuk mund të merren si përfaqësuese të popullatës së Kosovës dhe palëve të saj të interesit, ato gjithsesi ofrojnë njohuri që do të kontribuojnë në identifikimin nga UNDP-ja të fushave të ardhshme të angazhimit programatik për ta forcuar kohezionin social. Diskutimi i mëposhtëm i kryqëzon vëzhgimet e shkëmbyera gjatë punëtorive, me të dhëna paraprake nga literatura në dispozicion dhe burimet dytësore, si dhe konsultimet bilaterale të mbajtura si pjesë e këtij procesi.

Për t'i forcuar gjetjet e raportit, u ndërmor një proces validimi. Pjesëmarrësit nga punëtorja fillestare u ftuan në një seri të punëtorive të validimit, për t'i diskutuar gjetjet dhe përfundimet kyçe të raportit. Diskutimi i punëtorisë së validimit gjendet në shtojcën 3.

⁷ Të kuptuarit e lidhjeve ndërmjet ZRF-së dhe Parandalimit të Konfliktit/Kohezionit Social në Kosovë: Një shqyrtim i "Ndërtimit të konfidencës dhe besimit përmes Reduktimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Integritet Gjinnor", Raporti i Misionit IRH, Kosovë, Gusht 2018

2.KONTEKSTI AKTUAL NË LIDHJE ME KOHEZIONIN SOCIAL NË KOSOVË - GJETJET KYÇE NGA HULUMTIMI I UNDP/FBA

Kosova ka ecur shumë gjatë dy dekadave të fundit, nga konflikti i dhunshëm, tek ndërhyrja ndërkombëtare me krijimin e Administratës Civile të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe prezenca ushtarake transatlantike e NATO-KFOR, deri tek deklarata e njëanshme e pavarësisë e pranuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë, e cila është kontestuar nga Serbia. Kosova ka edhe lidhje të ngushta me Bashkimin Evropian (BE), dhe në vitin 2015 e nënshkroi Marrëveshjen e Asociim-Stabilizimit, duke u bërë kështu vend kandidat potencial për anëtarësimin në BE.

Kosova ka një popullsi prej rreth 1.8 milion banorësh⁸. Më shumë se gjysma e popullsisë është nën 25 vjeç, gjë që e bën popullsinë më të re në Evropë. Regjistrimi i fundit në Kosovë u mbajt në vitin 2011, duke e përjashtuar veriun e Kosovës. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 92.9 për qind e popullsisë është shqiptare, 1.5 për qind është serbe, dhe 5.6 për qind janë pakica të tjera.⁹ Si rezultat, ekziston një mosmarrëveshje për saktësinë e të dhënave, veçanërisht në mesin e komuniteteve serbe.¹⁰ Shqiptarët etnikë, që kryesisht i përkasin fesë islame, dhe shqip-folësit, përbëjnë shumicën e përgjithshme me 92.9 për qind.¹¹ Serbët formojnë grupin më të madh të pakicave në Kosovë, flasin serbisht dhe kryesisht janë të krishterë ortodoksë. Sipas vlerësimeve të bazuara në të dhënat e OSBE-së për vitin 2010 dhe 2013, komuniteti serb përbën 7.8 për qind të popullsisë së përgjithshme.¹² Në kuadër të vendbanimeve serbe, shqiptarët janë kryesisht pakicë. Komunitete më të vogla në Kosovë përfshijnë romët, ashkalinjtë, egjiptasit, boshnjakët, turqit dhe goranët.

Arritjet politike, reformat, legjislacioni në përputhje me standardet e BE-së, dhe krijimi i institucioneve qendrore që të gjitha këto i tregojnë përparimet e rëndësishme që nga konflikti. Kosova e nënshkroi Marrëveshjen e Asociim-Stabilizimit në vitin 2015, duke qenë vend kandidat potencial për anëtarësimin në BE. Në nivelin politik, dialogu Kosovë-Serbi i realizuar me ndërmjetësimin e BE-së që nga marsi 2011, u përqendrua kryesisht në marrëveshjet teknike për marrëdhëniet e përditshme, duke u zgjeruar në bisedime politike të nivelit të lartë nga fundi i vitit 2012, dhe duke çuar në Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013. Ky proces, në disa aspekte, ua ka mundësuar Serbisë dhe Kosovës të bëjnë hapa më konstruktivë sesa më parë drejt një normalizimi të çështjeve socio-politike, veçanërisht atyre që prekin Kosovën veriore. Sidoqoftë, fushat e ndjeshme si siguria, sundimi i ligjit, kompetencat e autoriteteve lokale dhe kontrolli i kufijve, nuk janë zgjidhur dhe madje janë përkeqësuar në vitet e fundit. Në vitin 2018, Presidentët e Kosovës dhe Serbisë e hodhën idenë e një 'korigjimi të kufijve', me gjasë që përfshin shkëmbimin e Kosovës veriore me rajonet me shumicë shqiptare.¹³ Propozimi është kritikuar si kërcënim për destabilizim më të gjerë në Ballkanin Perëndimor, si dhe ka kundërshtim të fortë vendor ndaj kësaj lëvizjeje, si në Kosovë ashtu edhe në Serbi.¹⁴

⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës. <http://ask.rks-gov.net/en/add-news/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2018/>

⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. *Kosova në shifra 2017*. Informacion i marrë në mars 2019 nga <http://ask.rks-gov.net/media/4404/kosovo-in-figures-2017.pdf>

¹⁰ Këto vlerësime mund të nën-përfaqësojnë serbët, romët dhe disa pakica të tjera etnike, sepse ato bazohen në regjistrimin kombëtar të Kosovës për vitin 2011, i cili përjashtoi veriun e Kosovës (një rajon kryesisht me popullsi serbe) dhe u bojkotua pjesërisht nga komunitetet serbe dhe rome në jug të Kosovës

¹¹ Bertelmann Stiftung, Raporti i Vendit, Kosovë, 2018

¹² Një pjesë shumë më e madhe sesa vlerësimi prej 1.5% në regjistrimin e popullsisë 2011.

¹³ Parlamenti Evropian (2018), Marrëdhëniet Serbi-Kosovë, Konfrontimi ose Normalizimi. Informacion i marrë në mars 2018 nga [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635512/EPRS_BRI\(2019\)635512_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635512/EPRS_BRI(2019)635512_EN.pdf)

¹⁴ Po aty.

Marrëveshja e Brukselit është përballur me kritika të vazhdueshme nga të dyja komunitetet. Zbatimi i masave të dakorduara ka qenë i pjesshëm, dhe është penguar nga shumë protesta qytetare dhe politike. Me gjithë presionin në rritje nga të dyja palët për të arritur përfundimisht një marrëveshje që mund të hapë derën e anëtarësimit në BE, marrëdhëniet mbeten të tensionuara dhe përparimi drejt normalizimit është aktualisht në një pikë pa lëvizje të mëtejme.¹⁵ Takimet rajonale shpesh janë të mbushura me probleme që lidhen me statusin e Kosovës, dhe Serbia shpesh nuk pranon të marrë pjesë në takimet ku është ftuar Kosova, gjë që ndonjëherë bën që Kosova të mbetet jashtë takimeve dhe iniciativave rajonale. Që nga nëntori i vitit 2018, marrëdhëniet tregtare janë në nivelin e tyre më të ulët për shkak të taksës së importit që Kosova e ka vendosur ndaj mallrave serbe. Kosova ngriti tarifa doganore për mallrat serbe dhe boshnjake nga 10 në 100 për qind, pasi Serbia e bllokoj anëtarësimin e Kosovës në Interpol, organizatën ndërkombëtare të policisë.¹⁶

Ndarjet politike, administrative dhe sociale vazhdojnë të jenë fuqimisht të pranishme përgjatë vijave etnike në Kosovë, si në pjesën tjetër të Ballkanit perëndimor. Tensionet ndërmjet serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës manifestohen më qartë në Kosovën veriore, në komunat e Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit; edhe pse janë të dukshme edhe në vende të tjera. Shfaqja e disa incidenteve, si nisja e një treni 'provokues' serb, vazhdimisht ka çuar në intensifikimin e tensioneve të reja mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës.¹⁷

Faktorët kyç strukturorë

Shumë prej këtyre dinamikave paraprake u referuan gjatë punëtorive, të cilat shërbyen për të identifikuar një ndërveprim të ndarësve dhe faktorëve strukturorë që e dëmtojnë kohezionin social në Kosovë. Siç tregohet nga këndvështrimet shumë të ndryshme të tre grupeve të pjesëmarrësve në punëtori, në Kosovë bashkëtojnë narrativa të ndryshme në lidhje me perceptimet për kohezionin social. Këto narrativa ndikojnë në të gjitha aspektet e jetës në Kosovë, dhe po shkëmbehen me gjeneratat e reja, gjë që kontribuon në polarizimin e mëtejme ndërmjet komuniteteve.


Dy faktorë kyç strukturorë vazhdojnë të shkaktojnë tensione në Kosovë: (i) statusi i pazgjidhur politik dhe; (ii) mungesa e një procesi gjithëpërfshirës "Ballafaqimi me të kaluarën". Më tej, u shfaqën tre tema kryesore, të cilat rrjedhin nga faktorët strukturorë dhe ndikojnë mbi to (në pjesën më të madhe në mënyrë negative). Këto tre tema u identifikuan në të gjitha punëtoritë (megjithëse me këndvështrime të ndryshme) si qendrore për kohezionin social në Kosovë. Ato janë: i) cilësia e udhëheqjes politike; ii) stagnimi në lidhje me ekonominë, qeverisjen dhe shërbimet sociale; dhe iii) mundësitë e bashkimit për ndryshime. Si të tilla, ato shërbejnë si kornizë në këtë raport për t'i strukturuar reflektimet dhe kontributin nga punëtoritë e kohezionit social. Siç tregohet përmes kodit të ngjyrave në figurën 1, mbizotërimi i këtyre faktorëve u identifikua si negativ në lidhje me kohezionin social dhe paqen e qëndrueshme në Kosovë nga pjesëmarrësit. Sidoqoftë, u identifikua edhe fakti që sfidat e përbashkëta në mesin e qytetarëve ofrojnë *potencialin* për ndërtimin e lidhjeve dhe urave matanë ndasive dhe për avancimin e ndryshimeve pozitive.

¹⁵ Parlamenti Evropian (2018), Marrëdhëniet Serbi-Kosovë, Konfrontimi ose Normalizimi. Informacion i marrë në mars 2018 nga [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635512/EPRS_BRI\(2019\)635512_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635512/EPRS_BRI(2019)635512_EN.pdf)

¹⁶ Reuters (2018). Kosova godet Serbinë dhe Bosnjën me tarifa doganore 100 për qind pas pengesës me Interpolin. Informacion i marrë në mars 2019 nga <https://www.reuters.com/article/us-kosovo-serbia-trade/kosovo-hits-serbia-bosnia-with-100-percent-customs-fees-after-interpol-snub-idUSKCN1NQ29W>

¹⁷ BBC (2017) Sherri i trenit pothuajse e nxjerr Kosovën dhe Serbinë nga shinat, informacion i marrë në janar 2019 nga <https://www.bbc.com/news/world-europe-38666279>

Figura 1: Ndërveprimi i ndarësve dhe faktorëve strukturorë që ndikojnë në kohezionin social në Kosovë



Diskutimet e punëtorive nënvizuan se popullsia e Kosovës mbetet thellësisht e ndarë sipas vijave etnike. Të kuptuarit e ndryshëm të mënyrës si interpretohet kohezioni social në Kosovë dhe narrativat përreth tij, varen nga mjedisi rajonal i punëtorisë. Për shembull, në një kontekst komuniteti u mor me diskutime mbi mënyrat 'si' të avancohet kohezioni social, ndërsa në një kontekst tjetër një komunitet tjetër nuk do të pajtohej me të njëjtin nocion të kohezionit social, dhe do të pyeste 'kohezion social - me kë?' Në mesin e pjesëmarrësve më të moshuar ishte e përsëritur pika që kohezioni social kishte qenë më i fortë në të kaluarën, gjatë kohës së Jugosllavisë, me një ndjenjë nostalgjie për një epokë të idealizuar të rritjes ekonomike dhe punësimit të plotë, ku ndarjet në mes të komuniteteve nuk ekzistonin.

Statusi politik i pazgjidhur i Kosovës u nënvizua si një çështje thellësisht polarizuese, që e mban një situatë të konfuzionit politik dhe një *status quo* që e kufizon rëndë zhvillimin e Kosovës. Gjatë punëtorisë në Mitrovicë të Veriut u theksua se Prishtina nuk është në gjendje të ushtrojë sovranitet të plotë në Kosovën e veriut. Ndërkohë që kuptohet se komunat, shpesh të deleguara nga ministrinë, ofrojnë shërbime publike, pjesëmarrësit në Mitrovicë theksuan menjëherë se arsimi, kujdesi shëndetësor dhe heqja e mbeturinave po sigurohej nga Serbia. Në dy punëtoritë e tjera, u shpreh se Beogradi po ofron mbështetje politike, financiare dhe administrative për serbët e Kosovës, dhe se ka elemente (individë dhe grupe) në kuadër të Kosovës së veriut që e manipulojnë komunitetin e Kosovës së veriut për qëllime politike.¹⁸ Në të vërtetë, disa individë nga Kosova e veriut shprehën hapur një ndjenjë të thellë të tjetërsimit, si dhe skepticizëm për qëllimin e Prishtinës ndaj tyre si qytetarë. Edhe nëse disa individë që banojnë në Kosovë të veriut i shohim më shumë si dashamirës, ata vunë në dyshim aftësinë e Prishtinës për t'i menaxhuar kufizimet komplekse rajonale, nacional-politike, të llogaridhënies dhe të bazuara në burime, për t'i mbrojtur dhe siguruar në mënyrë efektive funksionet themelore të institucioneve. Ndërkohë që deklaratat në punëtori nënvizonin mungesën e besimit të ndërsjellë ndërmjet komuniteteve, anëtarët e të dyja komuniteteve ishin të bashkuar në shprehjen e një shkalle skepticizmi të përbashkët sa i përket interesave të përfaqësuesve politikë në Prishtinë dhe Beograd të angazhuar në negociatat për statusin e Kosovës.

¹⁸ Sipas një studimi të UNDP-së, banorët në komunat veriore në përgjithësi raportojnë nivele më të ulëta të besimit në institucione sesa homologët diku tjetër në Kosovë. UNDP (2015). *Mozaiku i Kosovës, 2015*. Informacion i marrë në janar 2019 nga http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/kosovo-mosaic-2015.html

Çështja e statusit të pazgjidhur si një faktor strukturor

Derisa shpallja e pavarësisë e vitit 2008 është njohur ndërkombëtarisht nga më shumë se 100 shtete dhe gëzon mbështetje të madhe mes popullatës me shumicë shqip-folëse të Kosovës, ajo fuqimisht kontestohet nga Serbia, si dhe aleatët e saj me ndikim ndërkombëtar, dhe kundërshtohet nga shumica brenda Kosovës nga komunitetet që flasin serbisht. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së bisedimeve janë shfaqur dallime fundamentale në nivel politik. Për Prishtinën, bisedimet kishin synim të fitohej pranimi serb i Planit të Ahtisaarit (korniza e hartuar fillimisht nga Martti Ahtisaari, ish i dërguari i posaçëm i OKB-së - që vendosi strukturën e brendshme dhe shtetësinë e Kosovës). Për Beogradin, bisedimet janë përqendruar në përpjekjen për rishikim ose përmirësim të marrëveshjeve që i konsideron të meta ose të papranueshme (përfshirë Planin e Ahtisaarit).¹⁹ Mjedisi politik në lidhje me retorikën dhe diskursin për shumë çështje mbetet shumë i kontestuar. Ndërkohë ka ndarje të brendshme nga të dyja palët që u theksuan gjatë shqyrtimit si faktorë të mëtejme që ndikojnë në turbullirat aktuale.

Tensionet mes Kosovës dhe Serbisë në nivelet më të larta politike, veçanërisht në lidhje me statusin e Kosovës dhe zbatimin e marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013, kontribuojnë në efektet negative në nivelin lokal. Në këtë kontekst, komunitetet e prekura nga konflikti kanë mbetur kryesisht të ndara, gjeografikisht, kulturalisht dhe politikisht. Ndërkohë që është arritur një shkallë e integritimit politik, integrimi social, kulturor dhe ekonomik ka qenë minimal. Komunitetet jetojnë më shumë pranë njëri tjetrit sesa së bashku. Ka pasur disa përpjekje për ta vendosur një proces gjithëpërfshirës 'Ballafaqimi me të kaluarën', megjithatë rezultatet ishin të kufizuara, dhe pajtimi mbetet i pakapshëm. Narrativat përçarëse të konfliktit vazhdojnë të mbizotërojnë në diskursin politik dhe social. Kjo këmbëngulje është shtuar nga fjalët dhe veprimet e liderëve politikë dhe të komunitetit, të cilët e bazojnë legjitimitetin e tyre politik tek konflikti, pasi përjetësimi i narrativave të konfliktit është shfrytëzuar në mënyrë të përsëritur për të konsoliduar elektoratin vendas.

Statusi i kontestuar i sovranitetit të Kosovës mbetet kështu një faktor strukturor i konfliktit. Çështja e statusit vazhdon të ndikojë në aftësinë e kosovarëve për të përfituar nga marrëveshjet ndërkombëtare që gëzojnë pjesa tjetër e Ballkanit Perëndimor - për shembull, Kosova nuk e gëzon liberalizimin e vizave që i është dhënë pjesës tjetër të Ballkanit Perëndimor.

Rritja e pakënaqësisë nga të dyja palët e konfliktit origjinal rezulton nga realizimi i pjesshëm i aspiratave të pavarësisë së Kosovës. Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, popullsia e shumicës shqip-folëse është irrituar gjithnjë e më shumë nga dështimi i perceptuar i liderëve dhe institucioneve të Kosovës në realizimin e premtimeve për pavarësi sovranë, dhe perceptimi i lëshimeve të padëshiruara për agjendën politike serbe. Popullsia serbisht-folëse e pakicës është gjithnjë e më e alarmuar nga ajo që e percepton se është konsolidimi i pakundërshtuar i sovranitetit të Kosovës.

Në përgjithësi, mungon zbatimi i marrëveshjeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, gjë që ngrit pyetje të mëtejme në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare, dhe nëse nënshkruhet, do të zbatohet. Arritja e një konsensusi politik në Kosovë për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje përfundimtare bëhet më e vështirë me zbatimin e mundshëm të kushteve që potencialisht do të mund ta kërcënonin sovranitetin e Kosovës.²⁰ Deklaratat gjatë vitit 2018 në lidhje me korigjimin e kufijve kanë hapur diskursin për mundësinë e një 'shkëmbimi të territoreve'.

Pavarësisht nga statusi i njohur zyrtar, Kosova e veriut funksionon në shumë aspekte si pjesë integrale e Republikës së Serbisë, me institucionet e Kosovës së veriut që marrin mbështetje përmes fondeve nga Serbia. Përdoret dinari serb dhe qeveria në Serbi emëron një Ministër për 'Kosovën dhe Metohinë' me përgjegjësi të portfolios për zhvillimet rajonale në Kosovë.²¹ Për më tepër, komuniteti serb i Kosovës

¹⁹ ICG (2013), op. cit.

²⁰ Demokracia për Zhvillim (2018) *Marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë*. Informacion i marrë në janar 2019 nga: www.d4d-ks.org/en/infographics/final-agreement-kosovo-serbia-konacan-sporazum-kosova-srbije/

²¹ <http://kim.gov.rs/eng/v526.php>

është kërcënuar vazhdimisht dhe i është ndaluar përfshirja aktive në politikë. Sipas Institutit të Studimeve të Sigurisë së Bashkimit Evropian, 'kjo u theksua veçanërisht para dhe gjatë zgjedhjeve nacionale dhe lokale në Kosovë, kur politikanët lokalë serbë, si dhe punonjësit në institucionet publike (serbe), u kërcënuan ose u sulmuan për pjesëmarrje në procesin zgjedhor ose mbështetjen e kandidatëve të pavarur nga Lista Serbe - organizata politike e serbëve të Kosovës e kontrolluar nga Beogradi'.²² Ndërkohë që komunitetet serbe të Kosovës në Kosovën jugore, në një masë të madhe pranojnë dhe bashkëveprojnë me institucionet e Kosovës pas pavarësisë, ato megjithatë mbeten të izoluara nga pikëpamja sociale, duke jetuar në komunitete mono-etnike ose në komunitete të përziera me romë, ashkali dhe egjiptas. Ka pak shembuj të serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës që jetojnë në afërsi të ndërsjellë, duke shfaqur ndërveprim të përditshëm, por integrimi i mirëfilltë në strukturat institucionale të Kosovës nuk është bërë ende realitet.

Ndërkohë që disa thonë se pavarësisht pranisë së përhershme të strukturave të dyfishta, rrjedhave të financimit të dyfishtë, hierarkive të dyfishta dhe deri diku realiteteve të dyfishta, në shumë aspekte situata ka avancuar përtej 'sovrانيتit të dyfishtë'.²³ Kështu shfaqet një kontekst i ndërlikuar i qeverisjes, me qytetarët që përballen me sisteme burokratike të mbivendosura dhe konkurruese që shpesh janë kontradiktore dhe Kafkiane në kërkesat e tyre.

Organizatat e shoqërisë civile nga Serbia dhe Kosova i shkruan një letër të hapur udhëheqësisë së Bashkimit Evropian, kundër ndarjes së Kosovës ose shkëmbimit të territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke thënë se 'ribërja e kufijve dërgon një mesazh shumë të rrezikshëm tek qytetarët e Serbisë dhe Kosovës, si dhe tek i gjithë rajoni, që ekziston një mundësi e vërtetë për ta legjitimuar një propagandë të rrezikshme të pronësisë etnike mbi territorin - një parim që e ka shtyrë rajonin në disa raste në konflikte të përgjakshme'.²⁴ Në Kosovë, mijëra protestues të organizuar nga partia opozitare Vetëvendosje (VV) u mblodhën kundër propozimit të Presidentit për korrigjimin e kufijve.²⁵ Sipas anketës në qershor 2018, 65.2% e qytetarëve mendojnë se marrëveshja përfundimtare me Serbinë nuk duhet të nënshkruhet, nëse kjo marrëveshje nuk përfshin njohjen e Kosovës nga Serbia.²⁶

Mosbesimi mes komuniteteve vazhdon, si dhe një shkëputje dhe mosbesim mes popullatës dhe institucioneve të qeverisjes, një mosbesim në rritje ndaj politikës dhe ndërhyrjes ndërkombëtare, dhe një ndarje gjithnjë e më e dukshme në mes të gjeneratës së konfliktit të preokupuar me çështje të identitetit, sovranitetit dhe shtet-ndërtimit, dhe gjeneratës pas konfliktit, të izoluar ndërkombëtarisht, dhe të ngarkuar me një ndjenjë identiteti që rrjedh nga e kaluara. Gjenerata pas konfliktit në Kosovë, e ushqyer nga narrativat e konfliktit që zakonisht paraqiten si të vërteta absolute, dhe me një ndërveprim të kufizuar me anën tjetër të konfliktit fillestar që mund të sigurojë vëzhgim empirik për t'i sfiduar narrativat mbizotëruese, është në të njëjtën kohë e cenueshme nga paragjykimet e trashëguara.

Si shqiptarët e Kosovës ashtu edhe serbët e Kosovës e shohin veten si viktimat të agresionit të kryer nga komuniteti tjetër, dhe si rezultat, armiqësia dhe mosbesimi ndëretnik janë gjithnjë të pranishme. Në një shoqëri të vogël siç është Kosova, konflikti preku shumicën e banorëve direkt në nivelin personal, dhe këndvështrimet diametralisht të kundërta lidhur me të kaluarën nuk janë trajtuar kurrë në një dialog të Kosovës në themel për t'i adresuar përvojat dhe këndvështrimet me qëllim të shërimit të shoqërisë. Shumë pjesëmarrës të punëtorive konfirmuan se trashëgimitë e konfliktit mbahen gjallë përmes memorizimit të vazhdueshëm dhe një kulture politike që qëllimisht 'i mban plagët e hapura'. Gjatë punëtorive, u tha gjithashtu se ndarjet në sistemin

²²Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë (2018). Prishtina dhe Beogradi të humbur në normalizim; informacion i marrë në janar 2019 nga <https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief%205%20Belgrade%20and%20Pristina.pdf>

²³'Sovraniteti i Dyfishtë' ishte titulli i një raporti të ICG 2011. ICG (2011). *Kosova e Veriut: Sovraniteti i dyfishtë në praktikë*.

²⁴Ballkani Perëndimor Evropian (2018) *Letër e hapur për Federica Mogherini nga OSHC-të e Serbisë dhe Kosovës kundër ndarjes së Kosovës*. Informacion i marrë në tetor 2018 në www.europeanwesternbalkans.com/2018/08/07/open-letter-federica-mogherini-serbias-kosovos-csos-division-kosovo/

²⁵Balkan Insight (2018) *Mijëra në Kosovë protestojnë kundër propozimeve për "korrigjimin e kufijve"*. Informacion i marrë në tetor 2018 nga <http://www.balkaninsight.com/en/article/thousands-citizens-protest-against-kosovo-president-09-29-2018>

²⁶Demokracia për Zhvillim (2018) *Marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë*. Informacion i marrë në www.d4d-ks.org/en/infographics/final-agreement-kosovo-serbia-konacan-sporazum-kosova-srbije/

arsimor i mbajnë komunitetet të ndara, dhe simbolet e konfliktit janë gjithnjë të pranishme nga të gjitha palët. Sipas pjesëmarrësve, librat shkollorë dhe materialet mësimore përmbajnë elemente të nacionalizmit dhe paragjytimeve, duke nxitur të kuptuarit dhe narrativën e ndarë në lidhje me kontekstin. Kjo shërben vetëm për të forcuar përçarjet, stereotipizimin dhe viktimizimin²⁷, dhe është një faktor kyç që parandalon shërimin e Kosovës si komb. Siç u shpreh një pjesëmarrës në punëtori: *'Jemi në shekullin 21 dhe 20 vjet më vonë dhe ne jemi ende të mbërthyer ndërmjet luftës dhe paqes'*

Megjithëse dhuna reale gjatë dekadës së kaluar ka qenë e kufizuar në valë sporadike dhe jetëshkurtra të sulmeve me motive etnike, prania dhe mirëmbajtja e simboleve të konfliktit u mundësojnë palëve politike të interesit që të thirren në to, dhe ekziston rreziku që këto të mund të përdoren për rindezjen e dhunës. Simbolet e konfliktit dhe përkatësisë etnike të përmendura nga pjesëmarrësit ishin, për shembull, varrezat dhe vendet përkujtimore, kryqet ortodokse në shkolla, flamujt kombëtarë, etj. Kjo simbolikë ka implikime të rëndësishme për zgjidhjen pas një konflikti. Një studim i kohëve të fundit zbuloi se fëmijët e moshës gjashtë deri njëmbëdhjetë vjeç në Kosovë mund t'i perceptojnë me lehtësi dhe saktësi treguesit e zakonshëm social - siç janë ikonat ose imazhet - që ndërlidhen me grupe të lidhura me konfliktin (d.m.th. qoftë si shqiptar ose si serb).²⁸ Duke pasur parasysh që fëmijët në Kosovë rriten në shkolla të ndara, me pak ose aspak kontakte ndëretnike, kjo e heq mundësinë e bashkëveprimit me fëmijët nga grupet tjera etnike për ta dëshmuar vetë si është me të vërtetë realiteti 'tjetër', pasi që ata tashmë kanë nocione të paracaktuara për 'tjetrin'. Më e rëndësishmja, mënyra se si identifikohen fëmijët me një grup ndikon gjithashtu në qëndrimet dhe sjelljet e tyre ndaj 'të tjerëve', gjë që ndikon në gjeneratat e ardhshme dhe në kohezionin e ardhshëm social.²⁹

Me asnjë rezultat të dukshëm politik të pranueshëm për të gjitha palët, mbajtjen e paretshme e *status-quo-së* politike dhe mungesën e një procesi të suksesshëm të Ballafaqimit me të Kaluarën, situata në Kosovë vazhdon të ngjasojë me një konflikt të ngrirë. Ndërkohë që pjesëmarrësit e punëtorive thanë se shkëmbimet ndër-personale mes komuniteteve zhvillohen si pjesë e jetës së përditshme, shembujt e kohezionit social në një nivel më të thellë janë të rralla dhe, sipas pjesëmarrësve, qëndrimet ndaj njëri-tjetrit janë forcuar në disa raste. Pjesëmarrësit e punëtorive thanë se ndërveprimet ndër-personale mes komuniteteve etnike zhvillohen në sferat e tregtisë, ekonomisë dhe punës - si dhe në disa raste në rrjetet kriminale. Në thelb, ato bazohen në nevoja, interesa afatshkurtra dhe dëshirën për të gjetur zgjidhje praktike për problemet e përditshme. Si të tilla, u vu në dukje nga pjesëmarrësit e punëtorisë, këto raste nuk duhet të merren si tregues për kohezionin social ose përmirësimin e marrëdhënieve ndër-komunitare në një nivel më të thellë. Ndarjet e ngrira në shoqëri u përshkruan si një bllokim që parandalon zhvillimet pozitive në nivelin bazë nga marrja e kontrollit sistematik ose strategjik në nivelin politik. Tabloja e paraqitur gjatë procesit të punëtorisë është se derisa nuk ka appetite për kthimin në konflikt ndër komunitete, qytetarët janë në të njëjtën kohë *'larg nga përfaqimi i njëri-tjetrit'*, ku ka edhe raste të rritjes së tensionit dhe rrezik të përplasjeve në shkallë të vogël në mes të komuniteteve, siç u përmend nga pjesëmarrësit në Mitrovicë dhe Gjilan

U vërejt se një Grup Punues Ndërmintoror për Ballafaqimin me të Kaluarën dhe Pajtimin, i krijuar për t'u marrë me shkeljet e mëdha të të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare

²⁷ Këshilli i Evropës (2017) Drejtësia, kohezioni social dhe liria e mediave mbeten sfidat kryesore në Kosovë*. Informacion i marrë në tetor 2018 nga www.coe.int/en/web/commissioner/-/justice-social-cohesion-and-media-freedom-remain-top-challenges-in-kosovo-?desktop=true

²⁸ Ndhimja për fëmijët (2019) Si dhe kur i kuptojnë fëmijët grupet e lidhura me konfliktin. Informacion i marrë në mars 2019 nga <https://helpingkidsqub.com/2019/03/04/how-and-when-do-children-understand-conflict-related-groups/>. Siç citohet në

Pristina Insight (2019). Ngjyrat që Ndajnë, Informacion i marrë në mars 2019 nga <https://pristinainsight.com/the-colors-that-divide/>

²⁹ Po aty.

humanitare gjatë konfliktit të Kosovës, i cili ishte aktiv gjatë viteve 2012-2017, nuk arriti ta zhvillojë një strategji mbi drejtësinë tranzicionale.³⁰ Sipas një shqyrtimi të procesit, mungesa e vullnetit politik, udhëheqësia, menaxhimi efektiv dhe përfaqësimi i kufizuar nga komunitetet pakicë, ishin të gjitha arsyet e mungesës së përparimit.³¹ Presidenti i Kosovës kohët e fundit ka iniciuar krijimin e një Komisioni të së Vërtetës dhe Pajtitimit, i cili synon ta sigurojë bazën për dialog mes komuniteteve të Kosovës. Komisioni nuk do të drejtohet ose koordinohet nga komuniteti ndërkombëtar, dhe përshkruhet si një proces vendor.³² Procesi i planifikimit dhe përgatitja për Komisionin e kryer nga një komitet teknik që u krijua në maj të vitit 2018 u kritikua nga pjesëmarrësit e punëtorisë për mungesë të transparencës dhe përfshirjes së komunitetit.³³ Kishte edhe pyetje të ngritura gjatë sesioneve rreth qëllimeve të Presidentit, duke pasur parasysh të kaluarën e tij ushtarake.

Mungesa e përparimit me drejtësinë tranzicionale

Çështja e marrëdhënieve në mes të komuniteteve të shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës është e lidhur fort me mungesën e proceseve efektive dhe të suksesshme të drejtësisë tranzicionale. Sipas pikëpamjeve të shumë personave që i mbijetuan konfliktit, nuk ka pasur drejtësi, asnjë njohje, kompensim ose dëmshpërblim për krimet e luftës. Libri i Kujtesës i Kosovës i Qendrës për të Drejtën Humanitare thotë se gjatë konfliktit të armatosur të Kosovës në vitin 1999 u vranë gjithsej 10.812 shqiptarë të Kosovës. Nëntëmbëdhjetë vjet pas konfliktit, më shumë se 1.600 persona janë ende të zhdukur³⁴, kryesisht për shkak të sfidave të ndërhyrjes politike, mungesës së llogaridhënies në gjyqësor, dhe mungesës së shkëmbimit të informacionit.³⁵ Qendra për të Drejtën Humanitare vazhdimisht ka raportuar për dështimin e autoriteteve për t'i ndjekur penalisht krimet e luftës, kryesisht për shkak të mungesës së vullnetit politik për t'u përballur me të kaluarën, glorifikimit të kriminelëve të luftës dhe joefikasitetit nga ana e autoriteteve të prokurorisë.³⁶ Sipas Komisionerit të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, ndjekja penale dhe sanksionimi efektiv i të gjithë personave të përfshirë në krime lufte; sqarimi i fatit të personave të zhdukur; sigurimi i viktimave të luftës me dëmshpërblim të duhur; dhe mundësimi i kthimit vullnetar të personave të zhvendosur, janë të gjitha parakushtet për ta arritur paqen e qëndrueshme.³⁷

Menjëherë pas konfliktit, hetimet për lidhjen e ish-pjesëtarëve të UÇK-së me krimet e kryera kundër serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës ishin të kufizuara, në interesat e stabilitetit afatshkurtër.³⁸ Gjatë vitit 2015, Kuvendi i Kosovës miratoi një ndryshim kushtetues³⁹ dhe një Ligj për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar⁴⁰ për t'i ndjekur penalisht dhe për t'i gjykuar pretendimet nga Raporti i Këshillit të Evropës 2011, i cili pretendon shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar nga ish anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ndërkohë që zyrtarisht është pjesë e sistemit juridik të Kosovës, Gjykata Speciale gëzon një autonomi të plotë nga të gjitha institucionet e Kosovës, ajo ndodhet jashtë Kosovës

³⁰ <https://www.paxforpeace.nl/publications/all-publications/kosovos-framework-for-dealing-with-the-past-at-a-turning-point>

³¹ Po aty

³² <https://www.president-ksgov.net/en/news/the-president-established-the-preparatory-team-for-the-truth-and-reconciliation-commission>

³³ Në një intervistë me palët kyçe të interesit, u vërejt gjithashtu se transparenca dhe përfshirja e kufizuar e nivelit të komunitetit thjesht mund të reflektojë fazën e hershme në vendosjen e procesit.

³⁴ Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (2018), Kosova: 19 vjet pas konfliktit, mbi 1.600 persona ende të zhdukur. Informacion i marrë në tetor 2018 nga www.icrc.org/en/document/kosovo-19-years-after-conflict-over-1600-people-still-missing

³⁵ Dardan Berisha (2017), Sfidat e gjetjes së personave të zhdukur - Kosova, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara.

³⁶ Qendra për të Drejtën Humanitare (2017), Serbia dështon në ndjekjen penale të krimeve të luftës. Informacion i marrë në tetor 2018 nga www.hlc-rdc.org/?p=33617&lang=de

³⁷ Këshilli i Evropës (2017), Drejtësia, kohezioni social dhe liria e mediave mbeten sfidat kryesore në Kosovë. Marrë në janar 2018 nga <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/justice-social-cohesion-and-media-freedom-remain-top-challenges-in-kosovo?desktop=true>

³⁸ Këshilli i Evropës (2011), Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë, f. 3

³⁹ Ndryshimi i Kushtetutës së Kosovës, i disponueshëm në www.gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10997

⁴⁰ Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, i disponueshëm në www.gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11036

në Hagë, dhe financohet nga Bashkimi Evropian (BE). Juridiksioni i Gjykatës Speciale përfshin hetimin e krimeve të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë dhe menjëherë pas konfliktit në Kosovë.⁴¹ Në dhjetor 2017, anëtarët e Kuvendit të Kosovës, kryesisht nga koalicioni, filluan një iniciativë për shfuqizimin e Dhomave të Specializuara. Kjo iniciativë shkaktoi reagime të forta dhe negative nga komuniteti ndërkombëtar, mediat dhe shoqëria civile, dhe ngriti shqetësime serioze për angazhimin e liderëve politikë të Kosovës për t'i parë ndonjëherë këto krime të ndiqen penalisht.⁴²

Për më tepër, rinia e Kosovës nuk është e informuar në mënyrë adekuate për çështjet e drejtësisë tranzicionale, gjë që përkthehet në deficit ndërgjegjësimit për rëndësinë e trajtimit të së kaluarës. Duke marrë parasysh që rinia e Kosovës formon shumicën e popullsisë dhe është e ndjeshme ndaj versioneve të politizuara ose të manipuluar të historisë, duhet të investohet në edukimin e tyre dhe t'u prezantohen këndvështrime historike të bazuara në fakte.⁴³

Tema 1: Cilësia e udhëheqjes politike

Zhënjimi me udhëheqjen politike të Kosovës u shpreh fuqimisht gjatë gjithë punëtorive. Frustrimet u përqendruan në dështimin e perceptuar të udhëheqjes politike për ta avancuar rritjen ekonomike dhe për t'i përmirësuar shërbimet sociale. Pjesëmarrësit ishin të mendimit se janë hequr si prioritete çështje të tilla si ofrimi i shërbimeve, përfshirë shëndetësinë, arsimin, qasjen në drejtësi ose infrastrukturën publike, ndërkohë që e gjithë vëmendja tërhiqet nga qëllimet e politikave të tilla si integrimi në BE ose diskutimi i fundit për një shkëmbim të territoreve në mes të Serbisë dhe Kosovës.

Presioni dhe polarizimi në hapësirën politike nxit ndarje

Gjatë periudhës 2015-2017, tensionet politike që rrjedhin nga kundërshtimi ndaj zbatimit të marrëveshjeve bilaterale; ritmi i ngadaltë i perceptuar i zbatimit të programit të planifikuar dhe legjislacionit kyç, rezultuan në një ngërç politik, i cili nga ana tjetër çoi në zgjedhje të parakohshme parlamentare në vitin 2017.⁴⁴ Kontradiktat mbi Dhomat e Specializuara të përmendura më lart ishin një faktor tjetër që nxiti polarizimin. Protestat qytetare i reflektuan tensionet politike. Me gjithë formimin e një koalicioni të ri qeverisës, skepticizmi i vazhdueshëm për disa marrëveshje të Dialogut të Brukselit në mesin e komunitetit shumicë të Kosovës, i shoqëruar me vendosmërinë e dukshme politike për ta vazhduar dhe intensifikuar procesin e dialogut, u treguan nxitës të vazhdueshëm të këtyre pasigurive dhe tensioneve. Ky kontekst ka vazhduar të nxisë armiqësi brenda komuniteteve, mes komuniteteve, dhe ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve të tyre politike.

Konteksti jo-mikpritës social dhe politik nënkupton që grindja rreth Dhomave të Specializuara në momentin aktual rrezikon të prodhojë efekte të pafavorshme siç janë, polarizimi i mëtejshëm i marrëdhënieve ndëretnike, dëmtimi i stabilitetit politik dhe reformave institucionale, vonimi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke dëmtuar kështu edhe besueshmërinë ndërkombëtare të Kosovës.⁴⁵ Varësisht se ndaj kujt (nëse ka ndonjë) ngrihet aktakuzë, ish-drejtesit e UÇK-së mund të përpiqen të nxjerrin mbështetës për të protestuar, duke përdorur veteranët për t'i mobilizuar mbështetësit kundër gjykatës, dhe PDK dhe partitë e tjera nën aktakuzë mund të përdorin kërcënime të trazirave civile si strategji për mbijetesë politike.⁴⁶ Aktakuzat ka të ngjarë

⁴¹ Pax për Paqe (2017), vlerësimi i ndikimit të mundshëm të Gjykatës Speciale të Kosovës. Informacion i marrë në mars 2019 nga paxreport-assessing-the-potential-impact-of-the-kosovo-specialist-court.pdf

⁴² Komisioni Evropian (2018), Raporti i Kosovës* 2018, f. 17

⁴³ RECOM (2016) Edukimi për Drejtësinë Tranzicionale në Kosovë, f. 5

⁴⁴ Reuters (2017), ligjvënësit e Kosovës largojnë qeverinë me mocion mosbesimi. Informacion i marrë në janar 2019 nga <https://www.reuters.com/article/us-kosovo-politics-idUSKBN1861NX>

⁴⁵ Gezim Visoka (2017), Vlerësimi i ndikimit të mundshëm të Dhomave të Specializuara të Kosovës, f. 7

⁴⁶ Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (2017), *Analiza e Ekonomisë Politike të Kosovës*, f. 34

t'i prekin ish-udhëheqësit e UÇK-së në të paktën katër parti politike: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), NISMA dhe VV⁴⁷, çka mund të rezultojë në një vakum të pushtetit dhe ndryshime në tablonë e partive politike.

Një çështje tjetër me interes parësor që nxit polarizim politik është marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mbi parimet e përgjithshme të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe.⁴⁸ Asociacioni u kundërshtua në mesin e shumicës shqiptare kur u nënshkrua marrëveshja e parë në 2013, dhe pakënaqësia u forcua pas marrëveshjes së parimeve të përgjithshme të vitit 2015,⁴⁹ duke çuar madje deri në përdorimin e gazit lotsjellës nga partitë opozitare në parlamentin e Kosovës.⁵⁰ Kundërshtimi është kryesisht për shkak të shqetësimeve se kjo do ta ndajë Kosovën në bazë të komuniteteve etnike,⁵¹ ose që situata do të mund të zhvillohet në një entitet të ngjashëm me Republika Srpska në Bosnjë dhe Hercegovinë,⁵² gjë që përgjithmonë do ta dëmtonte integritetin dhe sovranitetin territorial.⁵³ Pas referimit të marrëveshjes në Gjykatën Kushtetuese nga Presidenti i Kosovës, Gjykata gjeti disa dispozita "të papajtueshme me frymën e kushtetutës", por vendosi që Asociacioni i Komunave me shumicë serbe do të themelohet në përputhje me statutin që do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.⁵⁴

Hartimi i statutit do të kërkojë balancimin në mes të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe interesit të përfaqësuesve të komunitetit serb. Ekipi Menaxhues që do të duhej ta hartonte Statutin u krijua në 2013 pas Marrëveshjes së Brukselit, por nuk ishte funksional për një kohë të gjatë.⁵⁵ Më 4 prill 2018, Kosova i dha një mandat Ekipit të Menaxhimit që të fillojë me hartimin e statutit të Asociacionit, dhe çështja ka qenë burim i fërkimeve politike që nga ajo kohë.⁵⁶

Gjatë punëtorive u ngritën shqetësime se politikanët nga të gjitha anët qëllimisht po e ruajnë *status quo*-në politike, pasi që kjo i shërben interesit të tyre politik. Pjesëmarrësit në punëtori kishin perceptimin se politikanët dhe drejtuesit e komunitetit e bazojnë legjitimitetin e tyre politik nga dinamikat e vazhdueshme të konfliktit, pasi përjetësimi i narrativave të konfliktit është shfrytëzuar në mënyrë të përsëritur për ta konsoliduar elektoratin vendas. Pjesëmarrësit në punëtori ishin dakord se gjuha përçarëse dhe nganjëherë nxitëse e përdorur nga liderhipi politik, nga të gjitha anët, çon në stereotipizime dhe paragjykime të mëtejme. Politika e frikës, që luhet nganjëherë, e rrit ndjenjën e kërcënimit, veçanërisht në mesin e komuniteteve jo-shumicë, gjë që krijon një ndjenjë që njerëzit mund të jenë të sigurt vetëm duke iu përmbajtur grupit të tyre. Diskutimet në lidhje me qëllimet e politikave të 'tablosë së madhe' perceptohen se kanë mungesë transparence, dhe nëse individët nuk kanë lidhje të ngushta me qarqet e pushtetit, nuk ka shumë informacione ose dialog publik për këto çështje. Të rinjtë nga të dyja komunitetet nuk merren parasysh dhe nuk u jepet një mundësi për të diskutuar ose për të marrë pjesë në ndonjë vendimmarrje. Kjo, sipas asaj çfarë është dëgjuar në punëtori, ka rezultuar me një sens të prekshëm lodhjeje dhe mosbesimi mes komuniteteve, me pak ose aspak energji për t'u bashkuar në procese të avokimit, që do të mund të kërkonin llogaridhënie nga udhëheqësit politikë për vendimet e tyre dhe udhëheqjen politike.

⁴⁷ Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (2017), *Analiza e Ekonomisë Politike të Kosovës*, f. 34

⁴⁸ Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe në Kosovë - parime të përgjithshme/elementë kryesorë, të disponueshëm në www.eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/150825_02_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements_en.pdf

⁴⁹ Grupi i Studimit të Politikave të Ballkanit, *Asociacioni i Komunave Serbe: Kuptimi i pikëpamjeve kontradiktore të shqiptarëve dhe serbëve*, f. 10

⁵⁰ Kristen Chick (2015), *Gazi lotsjellës bëhet normë në kuvendin e Kosovës teksa ligjvënësit protestojnë për lidhjet serbe*. Informacion i marrë në tetor 2018 nga www.latimes.com/world/europe/la-fg-kosovo-serbs-20151218-story.html

⁵¹ Grupi për Studime Juridike dhe Politike (2018), *Lidhja e dialogun Kosovë-Serbi me strategjinë e zgjerimit të BE-së - cilat perspektiva të anëtarësimit janë në diskutim*, f. 8

⁵² Grupi për Studime Juridike dhe Politike (2017), *Asociacioni i Komunave me shumicë Serbe në Kosovë (Asociacioni në ngërc)*, f. 5

⁵³ Grupi i Studimit të Politikave të Ballkanit, *Asociacioni i Komunave Serbe: Kuptimi i pikëpamjeve kontradiktore të shqiptarëve dhe serbëve*, f. 10

⁵⁴ Gjykata Kushtetuese (2015), Lënda Nr. KO 13/15 e disponueshme në http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ko_130_15_ang.pdf

⁵⁵ Grupi për Studime Juridike dhe Politike (2017), *Asociacioni i Komunave me shumicë Serbe në Kosovë (Asociacioni në ngërc)*, f. 5

⁵⁶ Komisioni Evropian (2018), Raporti i Kosovës* 2018, f. 48

Tema 2: Stagnimi në raport me ekonominë, qeverisjen dhe shërbimet sociale

Sipas shumë prej pjesëmarrësve të punëtorive, mungesa e perceptuar e udhëheqjes politike (dhe nganjëherë komunitare), së bashku me mungesën e transparencës në proceset politike, janë arsyt e dështimit të përkthimit të përfitimeve të arritura politike në përfitime konkrete për shumicën e popullatës së Kosovës. Ata ngritën çështje dhe pyetje se ku do të gjenden dividendët real të paqes të 20 viteve të fundit.

Frustrimet për dështimin e konsolidimit të përfitimeve përfshijnë: dështimin për të ofruar shërbime të duhura sociale; kushtet ekonomike për punësim; përparim në lidhje me çështje që lidhen me drejtësinë; ose çështje që kanë të bëjnë me arsimin dhe fuqizimin e të rinjve, dhe të drejtat e pakicave. Ekziston edhe zhgënjimi me një polarizim të rritur në shpërndarjen e pasurisë, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje që lidhen me përgjegjësinë sociale. Sipas Anketës së Pulsit Publik të UNDP-së për vitin 2018, më shumë se 29 për qind e kosovarëve konsiderojnë se problemi më i madh me të cilin përballet Kosova sot është papunësia, 14 për qind shënuan korrupsionin, dhe 8 për qind thanë varfëria.⁵⁷ Të anketuarit i përzgjedhën këto si çështjet më të mëdha që ndikojnë në mirëqenien e tyre sociale. Këto çështje u theksuan fuqishëm edhe gjatë gjithë punëtorive.

Asnjë dividend i paqes

Pavarësisht se ekonomia e Kosovës po rritet vazhdimisht mbi mesataren e Ballkanit Perëndimor në periudhën financiare pas krizës globale, të dhënat e Bankës Botërore tregojnë se Kosova mbetet vendi i tretë më i varfër në Evropë.⁵⁸ Rritja ekonomike nuk e ka ulur shkallën e lartë të papunësisë, nuk ka siguruar punë formale, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë, as nuk e ka kthyer trendin e emigracionit në shkallë të gjerë. Shkalla e papunësisë arrin në 30% dhe është dukshëm më e lartë për gratë, të rinjtë dhe komunitetet pakicë.⁵⁹ Mbi 30% jetojnë nën kufirin e varfërisë,⁶⁰ megjithëse Banka Botërore e rendit Kosovën në mesin e vendeve me të ardhura të mesme të ulëta.⁶¹ Papunësia perceptohet si çështja e vetme më e madhe që ndikon në mirëqenien sociale të kosovarëve, me një shkallë punësimi të të rinjve prej 58 për qind.⁶² Gati një në tre të rinj kosovarë konsiderohet 'NEET' (jo në arsim, punësim apo trajnim) (31.4 për qind për gratë e reja, 23.8 për qind për burrat e rinj).⁶³

Ofrimi i shërbimit të kufizuar publik dhe me cilësi të dobët, stagnimi i mundësive ekonomike dhe tensionet më të gjera rajonale, janë vetëm disa ndër faktorët që i dëmtojnë përpjekjet për ta ndërtuar një shoqëri të integruar dhe kohezive. Pothuajse 60 për qind raportojnë se e kanë konsideruar largimin nga Kosova.⁶⁴ Papunësia perceptohet si çështja më e madhe që ndikon në mirëqenien sociale të kosovarëve.⁶⁵ Edhe cilësia e arsimit mbetet një sfidë e madhe në Kosovë. Në rezultatet e një vlerësimi ndërkombëtar të arsimit, Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (PISA), Kosova u rendit në pesë vendet e fundit në nivel ndërkombëtar, dhe në vendin e fundit në rajon, me performancën e nxënësve 15-vjeçarë në fundin e poshtëm të të gjitha disiplinave të testimit.⁶⁶

⁵⁷ UNDP (2018) Pulsi Publik XIV. Qasur në Janar 2019 nga

skedari://C:/Users/alexandra.meierhans/Downloads/Final%2520Public%2520Pulse%2520XIV.pdf

⁵⁸Banka Botërore (2017) *Republika e Kosovës Diagnostika e Sistemit Vendor*

⁵⁹ <https://tradingeconomics.com/kosovo/unemployment-rate?embed=over+50%+for+youth+http://ask.rks-gov.net/media/3989/labour-force-survey-2017.pdf>

⁶⁰Banka Botërore (2017) *Republika e Kosovës Diagnostika e Sistemit Vendor*

⁶¹ <https://datahelpdesk.worldbank.org/knowledgebase/articles/906519-world-bank-country-and-lending-groups>.

⁶² <https://www.politico.eu/interactive/in-pictures-kosovo-10th-anniversary-future-being-shaped-by-its-youth/>

⁶³ Anкета e Fuqisë Punëtore 2017, Agjencia e Statistikave të Kosovës, <http://ask.rks-gov.net/media/3989/labour-force-survey-2017.pdf>

⁶⁴ Pulsi Publik: Sfidat dhe perspektivat e rinisë në Kosovë, UNDP, gusht 2018,

http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-analysis.html

⁶⁵ Pulsi Publik XIII, UNDP, nëntor 2017, http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-xiii/

⁶⁶ Banka Botërore 2017, Edukimi për Zhvillimin Global. Qasur në janar 2019: <http://blogs.worldbank.org/education/testing-testing-how-kosovo-fared-its-first-international-assessment-students>

Shkalla e varfërisë në Kosovë është disproporcionalisht e lartë në mesin e grupeve të caktuara - veçanërisht fëmijëve, familjeve me kryefamiljare femra dhe komuniteteve pakicë, përfshirë komunitetin rom, ashkali dhe egjiptas. Përrjashtimi nga pjesëmarrja e plotë në jetën shkollore, atë të punës si dhe atë politike të Kosovës është i përhapur gjithandej. Mungesa e mundësive ekonomike dhe pakënaqësia me elitat politike i kanë shtyrë qytetarët në kërkim të statusit të refugjatit ose që t'i ndjekin rrugët e emigracionit të paligjshëm. Gjatë vitit 2015, një numër i vlerësuar prej 74.434 personash⁶⁷ mori rrugën e paligjshme për në Evropë përmes Serbisë dhe Hungarisë, në kërkim të një jete më të mirë.⁶⁸

Punëtoritë theksuan se solidariteti familjar është i fortë dhe burim i rezistencës në mesin e të gjitha komuniteteve. Dërgesat/remitancat nga anëtarët e familjes jashtë vendit janë një burim vendimtar i të hyrave për shumë njerëz në Kosovë. Disa qytetarë i kanë gjithashtu pensionet e tyre dhe përfitime të tjera sociale nga koha kur kanë punuar jashtë vendit. Në vitin 2016, remitancat arritën në 662.9 milion euro, nga komunitetet e diasporës kryesisht banuese në Gjermani, Zvicër dhe vendet skandinave.⁶⁹ Këto struktura mbështetëse u referuan si vendimtare kundrejt shërbimeve të mangëta publike dhe rritjes së dobët ekonomike. Sipas pjesëmarrësve familja është gjithashtu aty ku kohezioni social është më i fortë. Fuqia e familjes si një faktor për kohezionin social është veçanërisht e dukshme në mesin e komuniteteve shqiptare duke pasur parasysh historinë e tyre të mbështetjes në strukturat familjare për t'i kapërcyer vështirësitë historike dhe politike.⁷⁰ Sipas pjesëmarrësve, komuniteti shqip-folës nuk ka pasur kurrë shërbime plotësisht funksionale të nivelit komunal apo qendror dhe gjithmonë është mbështetur në familje për ta mbushur atë boshllëk. Punëtoritë nxorën në pah se familja është në fund të fundit garantuese e jetës së përditshme, duke ndërhyrë dhe duke i zëvendësuar përgjegjësitë që normalisht i atribuohen shtetit, dhe duke gjetur zgjidhje afatshkurtra për sfidat e jetës së përditshme. Në të njëjtën kohë, megjithatë, pjesëmarrësit theksuan edhe se kjo nënkupton një barrë shtesë për familjet, veçanërisht për gratë - dhe se lidhjet e forta në nivelin familjar nuk kontribuojnë për një kohezion më të gjerë social ndër-komunitar (potencialisht madje, bëjnë të kundërtën).

Tema 3: Mundësitë e bashkimit për ndryshime pozitive

Dështimi i politikanëve për t'u përkushtuar sinqerisht në shërbimet sociale dhe në punësim, së bashku me shumë prioritete të tjera qytetare, sipas pjesëmarrësve të punëtorive, ka çuar në një ndjenjë të prekshme të lodhjes në mesin e njerëzve dhe komuniteteve - në të dyja anët e ndasive. Sidoqoftë, është e ulët energjia për t'u bashkuar në procese të avokimit që kolektivisht do të mund t'i mbanin udhëheqësit politikë përgjegjës dhe llogaridhënës për vendimet e tyre dhe udhëheqjen politike, pjesërisht si një funksion i zhgënjimit. Përvojat e lëndëve të mbetura në sektorin e drejtësisë, mungesa e qasjes në drejtësi për gratë, zbatimi selektiv i ligjeve dhe dështimi i autoriteteve për t'iu përgjigjur të drejtave të pakicave, u shprehën si shqetësime gjatë punëtorive. Zbatimi i dobët i ligjeve i atribuohet udhëheqjes politike të Kosovës, me pretendime se po zgjerohet boshllëku në mes të elitës politike dhe popullit. Një pjesëmarrës tha se shqetësimet e elitës nuk janë shqetësimet e përditshme të njerëzve të zakonshëm, dhe një numër i pjesëmarrësve pretenduan se ekziston një perceptim i pandëshkueshmërisë në rritje.

⁶⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2015), *Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës për vitin 2015*

⁶⁸ FES (2015) *Vërshimi i Kosovës për në BE, Njerëz, Arsye dhe Mënyra*, f. 3

⁶⁹ https://www.bti-project.org/fileadmin/files/BTI/Downloads/Reports/2018/pdf/BTI_2018_Kosovo.pdf

⁷⁰ Tim Judah (2008), *Kosova Ajo që të gjithë duhet ta dinë*

Besimi dhe optimizmi i ndjerë nga shqiptarët e Kosovës pas ndërhyrjes së NATO-s në 1999 dhe shpalljes së pavarësisë të vitit 2008, me synimin që Kosova të hapet para botës dhe të kontribuojë në prosperitetin dhe sigurinë e ardhshme në rajon, është zbehur. Besimi është zëvendësuar me zhgënjimin me elitat politike dhe ka çuar në një ndjenjë në rritje të inercisë në mesin e të gjitha komuniteteve. Pjesëmarrja politike vlerësohet të jetë e ulët, me shumë ankesa përgjatë punëtorive se njerëzit ndihen të përjashtuar politikisht. Ky perceptim është veçanërisht i theksuar tek të rinjtë, gratë në vendet rurale dhe komunitetet jo-shumicë.⁷¹

Kufijtë komunalë janë vendosur përgjatë vijave etnike, si pjesë e planit të Ahtisaarit, dhe për pasojë pakicat etnike i zgjedhin përfaqësuesit e tyre dhe e organizojnë jetën e tyre politike, ekonomike dhe sociale. Raportohet se 8 nga 10 komunat që udhëhiqen nga komunitetet pakicë e kanë performancën më të dobët (mungesa e diskutimit për raportet e auditimit, disiplinës financiare në pagesa, mbledhjes së tatimit në pronë, etj.).⁷² Ka edhe argumente se strukturat qeverisëse për ndarjen e pushtetit, si në institucionet e nivelit lokal ashtu edhe në ato të nivelit qendror, në Kosovë po riprodhojnë politikë nacionaliste dhe po e pengojnë tranzicionin në paqe të qëndrueshme.⁷³

Përkundër asaj që janë dëgjuar lloje të ngjashme të nevojave dhe ankesave nëpër komunitete gjatë seancave të punëtorive, pjesëmarrësit pretenduan se megjithatë përvojat përkthehen ndryshe në varësi të përkatësisë etnike, grupmoshave, vendndodhjes urbane/rurale dhe gjinisë. Sipas pjesëmarrësve kur u është bërë kjo pyetje, avokimi i përbashkët për të kërkuar ndryshim dhe llogaridhënie nga udhëheqësia politike rrallëherë është konsideruar si rrugë e mundshme. Kjo u shpjegua me përshkrimin e një ndjenje të lodhjes dhe inercisë, së bashku me mungesën e besimit që politikanët dhe institucionet do të marrin përgjegjësinë e vërtetë për përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë në Kosovë. Për më tepër, pjesëmarrësit e përshkruan shoqërinë civile si mjaft të dobët dhe shpesh herë të varur nga mbështetja e donatorëve ndërkombëtarë. Ndërkohë që OJQ-të varen nga donacionet, ato kanë tendencë të shmangin konfrontimin dhe kritikën. Platformat mediatike janë zakonisht shumë të polarizuara nga interesat e komunitetit.

Çdo kërkesë për llogaridhënie nga politikanët dhe institucionet qendrore në Prishtinë përgjegjëse për dështimin e përmbushjes së kërkesave të politikave, komplikohet edhe më shumë nga situata e Kosovës së veriut. Sipas pjesëmarrësve, mendimi i përgjithshëm nga Kosova jugore është se komuniteti në Kosovë të veriut po kërkon ta ndajë Kosovën përgjatë vijave etnike. Pikëpamja e përgjithshme nga Kosova e veriut është se ata i përkasin Serbisë dhe se ajo është pjesë e tokës që shqiptarët e Kosovës nuk arritën ta ndanin nga pjesa tjetër e Serbisë përmes konfliktit. Narrativa nga të dyja komunitetet pasqyron një logjikë të barabartë me zero, duke e portretizuar njërin anë ose si fituese, si 'tjetra' ose si viktima të një 'armiku'.

Struktura komplekse e qeverisjes që ka të bëjë me çështjen e statusit të pazgjidhur u pengon qytetarëve të bashkohen për ndryshime sociale, pavarësisht ankesave të përbashkëta. Proceset pjesëmarrëse për t'u bashkuar rreth ndryshimeve bëhen shpejt komplekse ose të politizuara, dhe në rastin më të mirë janë të dobëta ose të ngathëta për të pasur shumë ndikim. Disa diskutime treguan ndryshime të vogla në natyrën e procesit politik, me shembuj nga Gjilani, ku kryetarët e komunave duhej t'u drejtoheshin të gjitha komuniteteve në komunë me premtime për shërbime të përmirësuara sociale për të siguruar fitore në zgjedhje. Kështu, ata ngadalë po fillojnë t'i

⁷¹ Pulsu Publik (2018), UNDP dhe USAID, http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-xiv.html

⁷² Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (2017), Treguesit e Performancës për Qeverisjen Lokale

Niveli për vitin 2017, qasur në janar 2019 nga: http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/09/RaportiAuditimit_Indikatorret-per-performance-komunale_Eng.pdf

⁷³ Visoka dhe Richmond (2017) Pas Paqes Liberale? Nga Shtet-Ndërtimi i Dështuar në një Paqe Emancipuese në Kosovë.

përfshijnë edhe nevojat e pakicave në mesazhet e tyre. Ka edhe përmirësime në integrimin e pakicave në kuadër të disa komunave, siç është komuna e Kamenicës. Kryetari i kësaj komune e ka emëruar një nënkryetar serb për të komunikuar jo vetëm me punonjësit e tij, por edhe me elektoratin e tij serbë, të cilët përbëjnë rreth 5 për qind të popullsisë së komunës.⁷⁴

Në përgjithësi, mbetet shumë për t'u bërë, ose për t'u bërë ndryshe, për të gjetur rrugë për t'i bashkuar qytetarët rreth çështjeve që i shqetësojnë ata dhe rreth interesave të përbashkëta që i tejkalojnë përkatësitë etnike. Një pjesëmarrës në punëtori e përshkroi mungesën e apetiteve në aspektin e mobilizimit kolektiv për ndryshim duke thënë se *'Është më lehtë t'i kontrollosh njerëzit kur kanë frikë'*, duke reflektuar mbi situatën politike dhe narrativat e përzgjedhura nga liderë të ndryshëm politikë. Këto mund të jenë arsye të besueshme që mund ta shpjegojnë shkallën e mposhtjes kur eksplorohet ideja e kërkimit të udhëheqjes politike dhe llogaridhënies për vendimmarrje politike.

Aktorët kyç dhe dinamikat e mëtejme të theksuara nga hulumtimi

Tjetërsimi i rinisë

Me popullsinë më të re në Evropë, baza e rinisë u identifikua nga pjesëmarrësit e punëtorive si një faktor i rëndësishëm potencial për suksesin e Kosovës për zhvillim gjithëpërfshirës përmes rritjes së kohezionit social. Megjithatë, për momentin, popullsia e re e Kosovës kryesisht mbetet një burim i pashfrytëzuar, me më shumë se gjysmën që mendojnë të largohen nga Kosova.⁷⁵ Perspektivat e liberalizimit të vizave dhe efekti i tij i mundshëm tek të rinjtë kosovarë që duan të largohen nga Kosova, u përmendën vazhdimisht nga pjesëmarrësit.

Duke pasur parasysh rëndësinë mbizotëruese të rinisë si një grup i madh demografik, dhe për këtë arsye një aktor i rëndësishëm për kohezionin social, nuk janë vendosur politikat strategjike apo ndërhyrjet që do të mund të shkallëzoheshin deri në një shtrirje transformuese (për shembull shënjestrimi i problemit të punësimit të të rinjve). Rinia nga të gjitha komunitetet raportohet të jetë e zhgënjyer dhe e demotivuar për të ardhmen. Pjesëmarrësit e punëtorive thanë se ka pak platforma publike për sport, kulturë, koncerte apo vende të organizuara takimesh për rininë. Të rinjtë gjithashtu e perceptojnë veten të përjashtuar nga proceset politike dhe nuk e kanë mundësinë që të ndikojnë në mënyrën se si formësohet e ardhmja. Zhgënjimi i të rinjve është një faktor i vërtetë që mund ta shkaktojë destabilizimin e së ardhmes. Rinia e marginalizuar është e cenueshme ndaj rreziqeve personale, sociale dhe ekonomike, duke e përfshirë vetëvlerësimin e ulët, abuzimin e substancave, përfshirjen në elemente kriminale dhe rritjen e cenueshmërisë ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Mungesa e angazhimit të të rinjve mund të shpjegohet në një nivel nga strukturat e forta familjare, gjë që u jep pak hapësirë të rinjve që të përfshihen në vendime në lidhje me familjen, në krahasim me anëtarët më të moshuar të familjes. Gjithashtu, të rinjtë shihen si pjesë të njësisë familjare, dhe më pak vëmendje u kushtohet platformave kolektive për rininë, gjë që nga ana tjetër mund të shërbejë si rrugë për zhvillimin e kohezionit social në mesin e të rinjve në Kosovë.

Një fakt shtesë për t'u marrë parasysh dhe i rëndësishëm për kohezionin social është se gjenerata pas konfliktit në Kosovë, është e cenueshme ndaj paragjykimeve të trashëguara siç u diskutua më lart, të ushqyera nga narrativat e konfliktit që zakonisht paraqiten si *'të vërteta absolute'*, dhe me

⁷⁴ Financial Times (2019). Kryetari Komunal më i ri në Kosovë kërkon të lidhë ndarjen etnike, Informacion i marrë në mars 2019 nga <https://www.ft.com/content/c48ff9b2-8ff8-11e8-b639-7680cedcc421>

⁷⁵ Kosova Dy Pikë Zero (2018). Asnjë Dëshirë për t'u Kthyer, qasur në shkurt 2018: <https://kosovotwopointzero.com/en/no-desire-to-return/>.

ndërveprim tejet të kufizuar me anën tjetër në konfliktin fillestar. Sipas pjesëmarrësve të punëtorive, familjet kanë një rol të rëndësishëm në mënyrën se si përsëriten narrativat e vazhdueshme dhe si u transmetohen ato brezave të rinj.

Barazia gjinore

Megjithëse legjisllacioni për barazinë mes burrave dhe grave është gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ekzistojnë politika progresive për ta promovuar rolin dhe avansimin e grave, ekziston një shkëputje e theksuar në mes të retorikës politike dhe realitetit.⁷⁶ Gratë shpesh përballen me dhunë me bazë gjinore dhe diskriminim të lartë në tregun e punës, në gjyqësi, në polici dhe janë mjaft të nën-përfaqësuara në vendimmarrje, si në institucionet qendrore ashtu edhe në komuna.⁷⁷ Për më tepër, mungojnë të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë, dhe integrimi gjinor në ligje dhe politika mbetet i dobët.

Rëndësia e familjes si entitet në Kosovë ka pasoja për mënyrën se si është e organizuar shoqëria dhe krijon mundësi të pabarabarta për grupe të ndryshme, jo vetëm për gratë. Kosova ka një nga nivelet më të ulëta të pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore, dhe duke arritur në vetëm 12.7 për qind, gratë kosovare përballen me nivelin më të ulët të punësimit për gratë në Evropë.⁷⁸ Arsyet e mungesës mbizotëruese të mundësive në jetën publike ose në fuqinë punëtore për gratë janë përgjegjësitë familjare në kombinim me qasjen e kufizuar në kujdesin cilësor dhe të përbalueshëm për fëmijë dhe të moshuar.⁷⁹ Pavarësisht nga pasuria e familjes, gratë ende kanë më pak të ngjarë të zotërojnë shtëpi, tokë ose biznes, dhe vazhdojnë të përballen me sfidat në lidhje me trashëgiminë.⁸⁰ Pjesëmarrësit e punëtorive konfirmuan se rol luajnë edhe normat konservatore sociale dhe pritshmëria për rolin e grave në familje dhe shoqëri, së bashku me nivelet e ulëta arsimore. Mundësia që gratë të bashkohen pavarësisht ndasive për t'i trajtuar këto çështje nuk është hulumtuar në nivele domethënëse deri më tani.

Komuniteti ndërkombëtar dhe roli i tij

Në nivelin makro, pjesëmarrësit e punëtorive u shprehën se komuniteti ndërkombëtar mban përgjegjësi të madhe për disa nga zhvillimet negative politike, ekonomike dhe sociale të 20 viteve të fundit. Sidoqoftë, komuniteti ndërkombëtar është parë në një dritë shumë më pozitive kur bëhet fjalë për angazhimin dhe mbështetjen e dhënë në nivelin bazë. Sipas një përfaqësuesi të një OJQ-je që punon në sektorin e shërbimeve sociale: *"Pa komunitetin ndërkombëtar, shumë nga ajo që ne bëjmë në punën tonë nuk do të ekzistonte më"*. Si i tillë, komuniteti ndërkombëtar shihet si aktor i rëndësishëm në nxitjen e kohezionit social në Kosovë, megjithëse shumë pjesëmarrës e nënvizuan nevojën për një qasje më ndryshe prej asaj në të kaluarën.

Sidoqoftë, ka pasur kritika edhe në lidhje me mungesën e vetë-iniciativës dhe një qasje tejet oportuniste të OJQ-ve kosovare në varësi të prioritetëve dhe financimeve të donatorëve. Disa pjesëmarrës të punëtorive ishin dukshëm skeptikë sa u përket pyetjeve në lidhje me projektet me financim ndërkombëtar që kontribuojnë në kohezionin social dhe potencialin e tyre për të ndikuar pozitivisht në rezultatet politike ose të konfliktit. Derisa këto projekte janë në të shumtën

⁷⁶ Strategjia dhe plani i veprimit 2016-2020 për mbrojtjen nga dhuna në familje u miratua në vitin 2016, por sipas diskutimeve të ndara gjatë takimeve, zbatimi mbetet i dobët. Në vitin 2018 u emërua një koordinator kombëtar për mbrojtjen nga dhuna në familje, që konsiderohet një zhvillim pozitiv.

⁷⁷ Raporti i Komisionit të BE-së për Kosovën (2018) *Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, Komunikim mbi politikën e zgjerimit të BE-së*

⁷⁸ Kosova 2.0 (2017) Gratë pa punë, qasur në janar 2019 nga: <https://kosovotwopointzero.com/en/women-out-of-work/>

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ Raporti i Komisionit të BE-së për Kosovën (2018) *Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, Komunikim mbi politikën e zgjerimit të BE-së*

e rasteve të rëndësishme dhe të vlerësuara, pjesëmarrësit në punëtori thanë se ndërhyrjet e tilla nuk mund të pritet që ashtu të vetme të sjellin rezultate të qëndrueshme të kohezionit social.

Feja si faktor

Sa i përket identitetit fetar, shoqëria kosovare mbetet kryesisht laike në qëndrimet dhe sjelljet e saj. Myslimanët sunitë përbëjnë shumicën në kuadër të komuniteteve shqiptare, rome, ashkali, egjiptase, boshnjake, gorane dhe turke. Megjithatë, modelet e radikalizmit fetar të nxitura nga jashtë po ndikojnë gjithnjë e më shumë në shoqërinë kosovare. Respektimi i një interpretimi më fundamental të kodit islam po rritet, megjithatë, aktualisht këta individë që e miratojnë këtë mënyrë jetese mbeten të paktë kundrejt popullsisë së Kosovës.⁸¹ Edhe pse numri i qytetarëve të Kosovës që janë angazhuar në konflikte në Siri dhe Irak ka rënë në mënyrë të vazhdueshme ndërmjet viteve 2012 dhe 2016, pa asnjë rast të raportuar në 2017, përafërsisht 359 qytetarë të Kosovës⁸² u larguan për në zonat e konfliktit në Lindjen e Mesme, kryesisht si luftëtarë të huaj terroristë.⁸³ Që nga viti 2015 ka filluar një strategji dhe plan veprimi për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin dhe gjithashtu janë parë investime të rëndësishme ndërkombëtare për këtë çështje.⁸⁴

Ndërkohë që 5% e popullsisë janë katolikë⁸⁵, serbët e Kosovës janë pothuajse tërësisht të krishterë ortodoksë. Vlen të përmendet se Kisha Ortodokse Serbe është shumë thelbësore për identitetin e komunitetit serb të Kosovës, pavarësisht sa fetar është individ.⁸⁶ Historikisht, kisha ortodokse serbe ka qenë aktori i vetëm fetar që ka luajtur një rol të hapur politik në tablonë politike. Nga ana tjetër, historikisht feja nuk e ka përcaktuar se çfarë do të thoshte të ishe shqiptar, pasi studiuesit kanë treguar se ishte gjuha që shërbeu si faktori i vetëm më i rëndësishëm që bashkon shqiptarët, dhe në historinë moderne shkollat luajtën një rol të madh në identitetin shqiptar në Kosovë.⁸⁷ Sidoqoftë, pjesëmarrësit e punëtorive pasqyruan një perceptim që feja po shfrytëzohet dhe manipulohet për qëllime politike, në mbarë spektrin.

⁸¹ Bertelsmann Stiftung, Raporti i Vendit, Kosovë, 2018. Një imam i moderuar i intervistuar në mënyrë bilaterale si pjesë e këtij procesi hulumtues shprehu shqetësime për rritjen e xhamive konservatore të financuara dhe të mbështetura nga aktorë të jashtëm që kërkojnë të zgjerojnë ndikimin e tyre në Kosovë.

⁸² 255 burra, 49 gra dhe 55 fëmijë sipas UNDP-së (2017), Të Kuptuarit e Faktorëve Shtytës dhe Tërheqës, fq. 7

⁸³ Raporti i Komisionit të BE-së për Kosovën (2018) *Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, Komunikim mbi politikën e zgjerimit të BE-së*

⁸⁴ Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit (shtator 2015), 2015-2020 Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që çon në Terrorizëm.

⁸⁵ <http://www.balkananalysis.com/kosovo/2011/04/14/the-vatican-s-growing-prominence-in-kosovo/>

⁸⁶ Noel Malcom (1999), Kosova një histori e shkurtër,

⁸⁷ Tim Judah (2008), *Kosova Ajo që të gjithë duhet ta dinë*

3. PUNËTORITË E VËRTETIMIT TË GJETJEVE TË HULUMTIMIT/RAPORTIT

Ky shqyrtim i shkurtër i prioriteteve dhe çështjeve që ndikojnë në kohezionin social në Kosovë, ka demonstruar se kohezioni social në Kosovë ndikohet nga dy faktorë themelorë të konfliktit; (1) statusi i kontestuar i sovranitetit të Kosovës dhe (2) mungesa e një procesi të Ballafaqimit me të Kaluarën. Në analizën e diskutimeve të punëtorive dhe të dhënave të tjera të hulumtimit, u shfaq një pamje e një imazhi ciklik të rëndësishëm për kohezionin social në Kosovë. Çështja e statusit dhe mungesa e Ballafaqimit me të Kaluarën janë në qendër të ciklit, të rrethuara nga çështja e udhëheqësisë politike që shpesh përdor narrativa të ndarjes për përfitimet e tyre politike; gjë që rezultoi me vazhdimin e ofrimit të dobët dhe qeverisjes së dobët të shërbimeve publike, duke kontribuar në një ekonomi të dobët, që çon në mosbesim dhe zhgënjim në mesin e qytetarëve, duke i penguar kështu që të bashkohen për ndryshime.

Kjo marrëdhënie ciklike po kontribuon në mbajtjen e aspekteve të ngrira të konfliktit në Kosovë. Si rezultat, tensionet politike nuk janë zvogëluar me kalimin e kohës. Shtresa e ngrirë në shoqëri u përshkrua nga pjesëmarrësit e punëtorisë si një bllokim që parandalon zhvillimet pozitive në nivelin bazë nga marrja e kontrollit sistematik ose strategjik në nivelin politik.

Të trija punëtoritë demonstruan bashkëjetesën e narrativave shumë të ndryshme në lidhje me perceptimin e kohezionit social në Kosovë. Këto narrativa ndikojnë në të gjitha aspektet e jetës në Kosovë dhe po riprodhohen dhe ndahen me gjeneratat e reja pas konfliktit, dhe kjo kontribuon në polarizimin e mëtejshëm ndërmjet komuniteteve në Kosovë. Punëtoritë poashtu demonstruan se Kosova mbetet e ndarë përgjatë vijave etnike, dhe se ka shumë pak ndërveprim real dhe strukturor në mes të komuniteteve të ndryshme. Tabloja e paraqitur gjatë procesit të punëtorive është se përderisa nuk ka appetite për kthim në konflikt në mesin e komuniteteve, qytetarët në të njëjtën kohë janë larg nga të përqaftuarit me njëri-tjetrin.

Me gjithë dallimet në punëtori, kishte edhe një sërë fushash të përbashkëta. Ndërkohë që mund të debatohej se është e ndërlikuar të identifikohen pikat hyrëse për kohezionin social në Kosovë, komentet dhe informatat e marra (inputet) përgjatë punëtorive dhe takimeve, vazhdimisht shprehin një nevojë për përfshirje më të madhe përtej qarqeve të politikanëve/pushtetit, si dhe për dialogun në mes të komuniteteve dhe udhëheqësisë politike për ta formësuar të ardhmen e Kosovës. Diskutimet me pjesëmarrësit e punëtorive u përqendruan në sigurinë dhe prosperitetin real që vjen nga investimet afatgjata në qeverisje dhe në sundimin e ligjit, dhe se do të jetë shumë më efektive që Kosova ta ndërtojë fuqinë ripërtëritëse të shoqërisë dhe ta përmirësojë sigurinë njerëzore, sesa të vazhdojë me narrativat e fuqisë së rivalitetit dhe politikat e barabart me zero që aktualisht e kanë monopolizuar diskursin publik.

Ky arsyetim është shumë në përputhje me Raportin e Bankës Botërore (BB) dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) *Shtigjet për Paqe*, i cili tregon qartë se 'marrja e vendimeve gjithëpërfshirëse është thelbësore për ruajtjen e paqes në të gjitha nivelet, siç janë edhe politikat afatgjata për t'i adresuar aspiratat ekonomike, sociale dhe politike'.⁸⁸ Raporti argumenton se përjashtimi afatgjatë krijon tjetërsim dhe ankesa që mund të çojnë në zgjidhje të dhunshme të dallimeve. Diapazoni i gjithëpërfshirjes gjithashtu tregon se kur pikëpamjet përfaqësohen,

⁸⁸ Kombet e Bashkuara dhe Banka Botërore. *Shtigjet për Paqe: Qasje gjithëpërfshirëse për Paqen: Qasjet gjithëpërfshirëse për parandalimin e konfliktit të dhunshëm*. 2018

dëgjoen dhe integrohen, kjo e nxit kohezionin social dhe perceptimin e drejtësisë, dhe për këtë arsye ka më pak gjasa për ankesa që e ushqejnë konfliktin.⁸⁹

Kur merret parasysh kohezioni social në Kosovë, çështja e gjithëpërfshirjes duket themelore. Sot dialogu politik, siç shprehet nga pjesëmarrësit e punëtorive, është shkëputur nga shqetësimet e përditshme të qytetarëve. Përkundër numrit të madh të OJQ-ve dhe grupeve të avokimit të shoqërisë civile, institucionet rrallëherë këshillohen me ta, nëse nuk iu përputhen agjendat.⁹⁰ Shkalla dhe mënyra si përfaqësohen, dëgjoen dhe integrohen pikëpamjet dhe nevojat e komuniteteve të ndryshme, gjinive dhe grupmoshave në Kosovë, do të jenë një gur themeli për kohezionin social në të ardhmen. Pjesëmarrja domethënëse do të shërbente në këtë mënyrë si bazë për kohezionin social, dhe gjithashtu mund të fillojë t'i sfidojë disa nga aspektet 'e ngrira' të konfliktit në Kosovë.

Janë identifikuar edhe çështjet kyçe shqetësuese nëpër komunitete, siç është rëndësia e rinisë për forcimin e kohezionit social, ekonomisë dhe shërbimeve publike (arsim, kujdes shëndetësor, shërbime sociale etj.). Po ashtu, u pranuan hapat që janë ndërmarrë kur bëhet fjalë për kornizën ligjore të Kosovës, përkundër të gjitha sfidave që lidhen me zbatimin e ligjeve. Pjesëmarrësit në punëtori panë mundësi edhe kur bëhet fjalë për shkëmbimin ekonomik dhe marrëdhëniet ndërpersonale nëpër komunitete, dhe shprehën mundësi dhe gatishmëri për dialog në nivel bazë.

Sektori i drejtësisë dhe mediat u theksuan si mjete që sigurojnë një mjedis të favorshëm për kohezionin social dhe sigurimin e një hapësire për dialog gjithëpërfshirës dhe angazhim të grupeve me identitet të ndryshëm. Sidoqoftë, që të përdoren si burime për kohezionin social, nevojiten investime të konsiderueshme afatshkurtra dhe afatgjata. Komuniteti ndërkombëtar mund të luajë një rol në mundësimin e këtij procesi, por duhet të jetë i kujdesshëm në lidhje me kontekstin dhe nevojat lokale, dhe të përpiqet ta balancojë këtë me kërkesat dhe detyrimet e veta, sipas pjesëmarrësve të punëtorisë.

Pikat hyrëse sektoriale

(i) Mediat

Mediat tradicionale, së bashku me teknologjinë e re, duke i përfshirë edhe mediat sociale, kanë potencial të madh për rritjen e transparencës dhe ndërveprimin të politikëbërjes kosovare, dhe janë gjithashtu një mënyrë për t'i mundësuar proceset vendimmarrëse më pjesëmarrëse. Duke qenë se konteksti politik dhe agjendat e elitave politike u identifikuan nga pjesëmarrësit e shumtë në punëtori dhe të intervistuar si faktor vendimtar për parandalimin e transformimit të qëndrueshëm për paqen e qëndrueshme, mund të hulumtohet përdorimi i mediave si një platformë transformuese. Mediat mund të jenë një platformë për ta diskutuar nacionalizmin në rritje nga të gjitha palët, dhe të ndihmojë që diskutimet të merren më shumë me zgjidhjet e politikave për problemet e përditshme sesa çështjet e bazuara në identitet. Mund të ofrojë edhe një hapësirë ku mund të mblidhen të gjitha komunitetet për të dhënë këndvështrime të ndryshme dhe për t'i sfiduar paragjykimet e vazhdueshme që janë frenues të përhapur në ndërtimin e paqes.

⁸⁹ Kombet e Bashkuara. *Ndërtimi i paqes pas përfundimit të konfliktit (2012): Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm*, dokument i OKB A/67/499/S/2012/746

⁹⁰Bertelsmann Stiftung (2018), *Raporti i Vëndit, Kosovë*,

Kundër paragjytimeve dhe motivimit politik të mediave dhe mungesës së trajnimit të duhur të shumë gazetarëve për raportimin e çështjeve që kanë të bëjnë me të kaluarën, mediat duhet të trajnohen dhe të shfrytëzohen më mirë.⁹¹ Mediat tradicionale dhe sociale (përfshirë potencialisht televizionin qendror) duhet të ofrojnë hapësirë për t'i bashkuar qytetarët nga komunitetet e ndryshme për t'i diskutuar së bashku çështjet e përbashkëta dhe problemet e përbashkëta dhe për ta nxitur ndërveprimin e vërtetë ndër-komunitar.

(ii) Sektori i drejtësisë

Sektori i drejtësisë, përkundër të gjitha sfidave të tij, u pa si një hapësirë që, nëse menaxhohet në mënyrë korrekte, mund të kontribuojë në një mjedis të favorshëm për kohezionin social. Është arritur përparim i rëndësishëm, veçanërisht me integrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës dhe stafit të tyre mbështetës në të gjithë Kosovën në sistemin e unifikuar gjyqësor të Kosovës, me hetimin dhe ndjekjen penale të disa rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, si dhe me lansimin e procesit të aplikimit për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë konfliktit.⁹² Gjyqësori është ende i cenushtë nga ndikimet e papërshtatshme politike dhe institucioneve të sundimit të ligjit u duhen përpjekje të qëndrueshme për t'i ndërtuar kapacitetet e tyre. Lëndët e mbetura e të vonuara dhe joefikasiteti u vlerësuan si sfida madhore. Sidoqoftë, duke u bazuar në sukseset e sektorit të drejtësisë, zgjerimi i përfshirjes në proceset e vendimmarrjes në një mënyrë strategjike mund ta mbështesë punën për ta maksimizuar pavarësinë, llogaridhënien, profesionalizmin dhe efikasitetin e gjyqësorit. Për dhunën me bazë gjinore, u theksua se duhen përpjekje për ta mbështetur koordinimin e dobët në mes të policisë, prokurorëve dhe aktorëve të tjerë, dhe për ta adresuar monitorimin joadekuat nga policia dhe gjykatat të urdhrave të mbrojtjes në rastet e dhunës në familje. Është gjithashtu i nevojshëm një përkufizim ligjor i dhunës në familje dhe ngacmimit seksual, i cili duhet të futet në Kodin Penal.⁹³ Shoqëria civile mund të përfshihet më tej në debatin demokratik mbi sektorin e drejtësisë, dhe të jetë kontribues në hartimin dhe zbatimin e politikave në këtë fushë.

(iii) Angazhimi i aktorëve kyç

Gjatë diskutimeve nëpër punëtori, u identifikuan si dhe diskutuan një numër i aktorëve të rëndësishëm për kohezionin social. Politikanët në të gjitha nivelet u konsideruan si kontribues negativë në kohezionin social. Pjesëmarrësit e punëtorive identifikuan një numër aktorësh që mund të luanin një rol pozitiv për kohezionin social në Kosovë. Kjo mund të shërbejë si diçka që duhet të medohet dhe të merret parasysh në të ardhmen mbi angazhimin për kohezionin social. Aktorët pozitivë përfshinin gra dhe të rinj, të cilët aktualisht kanë mbetur jashtë proceseve politike dhe vendimmarrjes.

Ndërkohë që pjesëmarrësit vunë në pah se komuniteti ndërkombëtar e luan si rolin negativ ashtu edhe atë pozitiv, të gjitha punëtoritë e konfirmuan se komuniteti ndërkombëtar duhet ende të luajë një rol të vlefshëm (dhe të nevojshëm) që ta vazhdojë mbështetjen e Kosovës në mënyrë aktive për krijimin e një mjedisi të favorshëm për kohezionin social. Sidoqoftë, u tha se komuniteti ndërkombëtar duhet të jetë i ndërgjegjshëm për kontekstin dhe nevojat lokale, dhe të përpiqet t'i balancojë me kërkesat dhe detyrimet e veta. Për më tepër, në një nivel gjeopolitik, komuniteti

⁹¹ Eurozine. Kosovë: Lajme të rreme në një demokraci në vështirësi, qasur në janar 2019: <https://www.eurozine.com/kosovo-fake-news-in-a-struggling-democracy/>.

⁹²Raporti i Komisionit të BE-së për Kosovën (2018) *Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, Komunikim mbi politikën e zgjerimit të BE-së.*

⁹³Raporti i Komisionit të BE-së për Kosovën (2018) *Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, Komunikim mbi politikën e zgjerimit të BE-së.*

ndërkombëtar ka një rol të rëndësishëm në nxitjen e sqarimit të statusit politik. Pa mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar në këtë drejtim, një nga faktorët kyç strukturorë të konfliktit në Kosovë do të mbetet i paadresuar.

Duhet të theksohet se Kombet e Bashkuara kohët e fundit e filluan procesin e një Strategjie të Ballkanit Perëndimor mbi *Ruajtjen e Paqes përmes Pajtimit, Ndërtimit të Mirëbesimit dhe Dialogut*. Qëllimi kryesor i Strategjisë së propozuar është që ta shfrytëzojë angazhimin e bashkuar të OKB-së, në partneritet me aktorët kyç, në mbështetje të paqes dhe pajtimit të qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor. Në veçanti, synohet të promovohen qasjet rajonale për ndërtimin e marrëdhënieve pajtuese dhe të besueshme në të gjitha nivelet në kuadër të dhe ndërmjet shoqërive dhe komuniteteve, duke bashkuar për efekt maksimal ekspertizën, qasjen, mandatet dhe njohuritë institucionale të mbarë sistemit të OKB-së. Strategjia i bën jehonë vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB në fjalimin e tij para Asamblesë së Përgjithshme më 16 janar 2018, ku e theksoi urgjencën e “një përpjekjeje të bashkërenduar për zgjidhje që çojnë në stabilitet afatgjatë në Ballkanin Perëndimor”.

SHTOJCA 1 - PROJEKTET E UNDP-së NË KOSOVË

Projekti fillestar **“Mbështetje për komunat veriore”** (2013 - 2014) u zgjerua në **“Aksionin për Udhëheqje dhe Bashkëpunim Komunal”**, i cili përfundoi në dhjetor 2017. Ambasada Norvegjeze në Prishtinë ishte donatori kryesor, kurse UNDP në Kosovë ndau një pjesë të shpenzimeve të projektit. Projekti u përqendrua në ofrimin e mbështetjes teknike dhe të ekspertëve për shërbimin civil dhe udhëheqjen komunale, ndërsa bashkëpunimi ndër-komunal u përpoq ta krijojë një bashkëpunim më zyrtar për zhvillimin e kapaciteteve mes komunave veriore dhe komunave në pjesën tjetër të Kosovës. Identifikimi i prioriteteve afatshkurtra dhe afatmesme të zhvillimit, në konsultim me komunitetet lokale, rezultoi në zhvillimin e disa projekteve infrastrukturore të cilat u financuan nga donatorët.

“Mbështetja për forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë” punon për forcimin e një sistemi të pavarur dhe efektiv të drejtësisë, i cili mbron dhe promovon standardet e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë në grupet e cenueshme (gra dhe pakica), duke siguruar qasje më të mirë në drejtësi për të gjithë qytetarët. Ndërgjegjësimi i shtuar i qytetarëve për ndërmjetësimin dhe ndihmën juridike falas ka siguruar që më shumë qytetarë të përfitojnë nga sistemi i drejtësisë. Zbatimi i standardeve të të drejtave të njeriut në procedurat gjyqësore gjithashtu ka kontribuar në rritjen e besimit në sistemin gjyqësor nga të gjithë qytetarët.

“Programi Drejtësia 2020” (2018), i zbatuar bashkërisht nga UNDP, UN Women, UNICEF dhe UNFPA, u bazua në një partneritet holistik me institucionet kyçe, si Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Akademia e Drejtësisë dhe OShC-të, për ta forcuar funksionimin dhe efektivitetin e ndihmës juridike dhe shërbimeve të ndërmjetësimin. Në bazë të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut, UNDP-ja e ka përmirësuar qasjen në drejtësi dhe është rritur ndërgjegjësimi për grupet e marginalizuara, përfshirë gratë dhe komunitetet romë, ashkali dhe egjiptase (RAE). Si i tillë, projekti kontribuoi në fuqizimin e komuniteteve të marginalizuara për të kërkuar qasje në të drejtat që u takojnë. Programi adresoi edhe çështjet e Dhunës së Bazuar në Gjini (DhBGj), duke u përqendruar në tejkalimin e pengesave për të hyrë në tregun e punës, gjetjen e punësimit dhe sigurimin e të hyrave për jetesën më të mirë të të mbijetuarve të DhF/DhBGj dhe viktimave (të mundshme), duke punuar nga afër me aktorët lokalë dhe mekanizmat e koordinimit të DhF/DhBGj në katër komunat veriore.

“Mbështetja për Drejtësinë Tranzicionale në Kosovë” (2014-2018)

Mbështetja për Drejtësinë Tranzicionale në Kosovë (STJK) është një ndërmarrje e përbashkët e UNDP, OHCHR, UN Women dhe IOM, nën ombrellën e Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT). Ndërkohë që aktivitetet kryesore të projektit përfunduan në vitin 2017, komponenti i fundit **“Themelimi i një Qendre Burimore të DT në Universitetin e Prishtinës”**, përfundoi në shtator 2018.

Objektivi i projektit u përqendrua në rritjen e aftësive të aktorëve vendimtarë institucional dhe të shoqërisë civile në Kosovë për t'u përfshirë dhe për ta drejtuar procesin e drejtësisë tranzicionale gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse, me viktimat në qendër dhe të ndjeshme ndaj gjinisë. Kjo qasje e synonte përmirësimin e marrëdhënieve të komunitetit, forcimin e besimit qytetar dhe, në planin afatgjatë, të kontribuojë në pajtimin dhe parandalimin e dhunës në të ardhmen.

“Iniciativa kosovare për persona të zhdukur për ta rritur stabilitetin dhe për ta përmirësuar pajtimin duke u ballafaquar me çështje nga e kaluara” (2016 - në vazhdim)

Projekti ka qenë i suksesshëm në bashkimin e palëve të interesit dhe partnerëve lokalë, duke zhvilluar hulumtime për ndryshimet e politikave dhe duke u përqendruar në shoqatat e familjarëve. Në bashkëpunim të ngushtë me donatorin, projekti ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve të institucioneve dhe shoqatave të familjarëve në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me personat e zhdukur. Për më tepër, projekti ka dhënë rekomandime konkrete sa i përket zhvillimit dhe rishikimit të infrastrukturës ligjore. Për më tepër, përmes forumeve dhe konferencave të përbashkëta, projekti ka kontribuar në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ndërmjet shoqatave të familjeve, në promovimin e çështjes së personave të zhdukur si një shqetësim i përbashkët. Në bashkëpunim me ICMP, projekti ka arritur rezultate konkrete në analizimin e ADN-ve dhe përputhjen e mostrave pas vdekjes.

Dialogu ndër-komunitar përmes Ruajtjes gjithëpërfshirëse të Trashëgimisë Kulturore (2018 - në vazhdim)

Projekti i financuar nga BE-ja “Dialogu ndër-komunitar përmes Ruajtjes gjithëpërfshirëse të Trashëgimisë Kulturore” do të punojë në ndërtimin e mëtejshëm të besimit në mes të komuniteteve në Kosovë, përmes pranimit të përmirësuar ndër-komunitar dhe respektimit të identitetit kulturor dhe trashëgimisë së të gjitha komuniteteve të Kosovës. Trashëgimia kulturore është një element thelbësor i përpjekjeve të rindërtimit social të Kosovës, duke siguruar një “linjë vazhdimësie” që e lidh realitetin pas konfliktit me një “normalitet” para konfliktit, dhe që e mbështet kalimin nga pas-konflikti në një zhvillim të qëndrueshëm. Në Kosovë, ku shkëmbimi ndër-komunitar është i kufizuar dhe të kuptuarit e trashëgimisë së tjetrit është i kufizuar, mbrojtja e trashëgimisë së prekshme dhe jo-materiale kulturore mund të shërbejë si një instrument për të ndërtuar besimin ndër-komunitar. Kohezioni i komunitetit përmes trashëgimisë kulturore të prekshme dhe jo-materiale ka gjithashtu vlerë për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e mundësive për punësim, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë. Ky projekt është faza pasuese e projektit fillestar “Ndërtimi i besimit përmes mbrojtjes kulturore në Kosovë” (2016-2017).

Projekti **Zhvillimi i Integruar i Territorit 2** bazohet në sukseset e projektit të ADC-UNDP “Reagimi në nivel lokal për Zhvillimin e Punësimit dhe Zhvillimin e Integruar të Territorit (InTerDev)”, i cili është zbatuar që nga viti 2014 në rajonin jugor të Kosovës, në komunat e Dragashit dhe Shtërpçës. Objektivi i përgjithshëm i projektit përqendrohet në krijimin e të hyrave gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, dhe është përmirësuar krijimi i vendeve të punës për gratë dhe burrat në komunat Dragash (komuniteti goran), Shtërpçë (komuniteti serb) dhe Viti (komuniteti shqiptar).

Projekti fillestar i **“Iniciativës për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë në Kosovë”** i hapi rrugën projektit **“Mbështetja e Iniciativës për Ripërtirje ndaj Fatkeqësive për Kosovën”**, duke punuar në forcimin e kapaciteteve të vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike, dhe në identifikimin e prioriteteve për t’i informuar strategjitë e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike, dhe për zhvillimin e programit. Projekti e ka realizuar raportin e Vlerësimit të Nevojave Lokale për periudhën Pas fatkeqësisë (LPDNA) dhe Kornizën e Rikuperimit të Hershëm dhe Planin e Veprimit (ERFAP) pas vërshimeve të mëdha në komunat veriore të Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit në pranverën e vitit 2014. Projekti gjithashtu e mundësoi takimin e parë në mes të të gjithë zjarrfikësve të komunave veriore dhe Shefit të Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave/Ministritë së Punëve të Brendshme.

“Mbështetja për zbatimin e politikës dhe strategjisë pyjore në Kosovë” (i përfunduar) ka synuar në ngritjen e kontributit të sektorit pyjor në ekonomi përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve pyjore, duke marrë parasysh qëllimin e shumëfishtë të sektorit pyjor, përfshirë përfitimet ekonomike, sociale dhe mjedisore, si dhe kontributin e tij në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Projekti u zbatua bashkërisht nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e OKB-së dhe UNDP-ja. Objektivi i komponentit të UNDP-së kishte për qëllim zhvillimin e kapaciteteve për menaxhimin e pyjeve në komunat veriore, si dhe identifikimin dhe ndërtimin e shkathtësive të përfituesve të mundshëm, pronarëve të pyjeve private dhe ndërmarrësve të mundshëm në sektorin e pylltarisë, për të promovuar masa aktive të punësimit. Këto masa u përqendruan tek gratë dhe burrat e rinj, fermerët e vegjël dhe grupet e tjera të cenueshme.

SHTOJCA 2 - AGJENDA E PUNËTORISË



Empowered lives.
Resilient nations.

Kohezioni Social në Kosovë: Identifikimi i Faktorëve të Rrezikut të Konfliktit dhe Shtigjet e reagimit të mundshëm Dialogu Strategjik për ta informuar Analizën e Konfliktit të UNDP-së Agjenda e Punëtorisë

E hënë, 22 tetor 2018, në Hotel Prishtina,	
08:45- 09:00	Arritja dhe regjistrimi
09:00- 09:15	Mirëseardhja <ul style="list-style-type: none">Alessandra Roccasalvo, Zëvendës Përfaqësuese e Përhershme e UNDP-së në KosovëSHSZnj. Karin Hernmarck Ahliny, Ambasadore e Suedisë (të konfirmohet)
09:15-09:30	Korniza e ditës - Hyrje
09:30- 10:45	Konflikti dhe ndërtimi i paqes në Kosovë - skanim i kontekstit <i>Ekspertët panelistë shkëmbejnë këndvështrime mbi kontekstin aktual në Kosovë, duke ofruar njohuri si për faktorët e rrezikut ashtu edhe për mundësitë për të avancuar ndërtimin e paqes dhe kohezionin social, pasuar nga diskutimi plenar.</i>
10:45- 11:00	Çaj/kafe
11:00- 13:00	Grupe tematike për të shpalosur faktorë të ndryshëm (ekonomik, social, mjedisor, politik dhe rajonal) që e formësojnë konfliktin dhe tensionet në Kosovë <i>Si kontribut kyç në analizën e konfliktit të UNDP-së, pjesëmarrësit punojnë në grupe që i identifikojnë bashkuesit dhe ndarësit e sotëm në sektorë të ndryshëm në lidhje me dinamikën e konfliktit dhe mundësitë për ndërtimin e paqes dhe kohezionit social.</i>
13:00- 14:00	Dreka
14:00- 15:15	Çfarë po shpalosin skenarët e mundshëm? Cilat ndërhyrje mund të parashikohen për ta avancuar paqen dhe kohezionin social në Kosovë? <i>Diskutim i mundësuar përmes fasilituesit për identifikimin e bashkuesve dhe ndarësve.</i>
15:15- 15:30	Përmbledhje dhe mbyllje.

SHTOJCA 3 - PUNËTORITË E VALIDIMIT TË GJETJEVE TË HULUMTIMIT/RAPORTIT

Për t'i validuar gjetjet e raportit dhe për t'u siguruar që pikëpamjet ishin të përfaqësuar siç duhet, u mbajtën katër punëtori validimi në Mitrovicë dhe Prishtinë, duke e përfshirë edhe atë me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT).

Për shkak të fushëveprimit të metodologjisë, përfundimet e paraqitura nuk mund të merren si përfaqësuese të popullatës së Kosovës dhe palëve të interesit të vendit, megjithatë gjetjet sigurojnë njohuri që do të kontribuojnë në identifikimin (nga UNDP/UNKT) të fushave të ardhshme të angazhimit social. Diskutimi i mëposhtëm i kryqëzon vëzhgimet e shkëmbyera gjatë punëtorive dhe hulumtimeve paraprake, me diskutime të mëtejme dhe të dhëna të mbledhura gjatë punëtorive të validimit të mbajtura në Kosovë nga 2 - 4 prill 2019. FBA-ja mbështeti edhe punëtoritë e validimit, përmes planifikimit të punëtorisë, dizajnit dhe mundësive facilituese, si dhe me mbështetje financiare ndaj procesit.

Vëzhgimet e shkëmbyera gjatë punëtorive të validimit strukturohen më tej në raport dhe i validojnë gjetjet dhe përfundimet e nxjerra. Në punëtoritë e validimit morën pjesë 41 pjesëmarrës që përfaqësojnë institucione kombëtare, shoqërië civile, përfaqësues të komunitetit dhe organizata ndërkombëtare. Pjesëmarrësit nga punëtoritë e para në tetor u inkurajuan shumë të marrin pjesë në mënyrë që t'i validojnë të dhënat dhe gjetjet nga ato diskutime. Mbi 60% e pjesëmarrësve ishin gra. Në Mitrovicë, shumica e pjesëmarrësve përfaqësonin komunitetin serbisht-folës, dhe në punëtoritë e tjera, shumica e përfaqësonin komunitetin shqip-folës. Fatkeqësisht, në punëtori mungoi pjesëmarrja e pakicave të tjera kosovare. Të pranishëm ishin edhe një numër i përfaqësuesve nga komuniteti ndërkombëtar. Një numër i vogël i pjesëmarrësve e përfaqësuan rininë. Sërish, asnjë përfaqësues fetar nuk ishte i pranishëm në asnjërën prej punëtorive.

Raporti iu paraqit pjesëmarrësve dhe pastaj u diskutua përmes një diskutimi të mundësuar përmes facilituesit (shembulli i agjendës së njërës prej punëtorive është i bashkangjitur në Shtojcën 4).

Në përgjithësi, pjesëmarrësit u pajtuan me gjetjet e raportit, diagramin e zhvilluar që i përshkruan faktorët strukturorë, dhe temat në lidhje me kohezionin social dhe pengesat kryesore, si dhe me pikat kyçe të mundshme hyrëse për forcimin e kohezionit social në Kosovë. Për çështjet strukturore të mungesës së proceseve të ballafaqimit me të kaluarën dhe çështjes së statusit të pazgjidhur të Kosovës, pjesëmarrësit ranë dakord që të gjitha diskutimet mbi kohezionin social dhe narrivat ekzistuese të konfliktit lidhen me njërin nga këto, në mos me të dyja çështjet e tilla të ndërthurura. Ndërkohë që raporti përqendrohej në komunitetet serbe dhe shqiptare, ata ranë dakord që për të dyja, përfshirë komunitetet pakicë, narrivat e konfliktit i kalohen gjeneratës së re. Më tej, pjesëmarrësit deklaruan se ka mungesë të një komunikimi të mirëfilltë që zhvillohet në dhe ndërmjet komuniteteve, dhe kjo shpesh shpie në transmetimin e narrativave të rreme. Meqenëse nuk ka pasur një proces kombëtar dhe gjithëpërfshirës për ballafaqimin me të kaluarën, faktet dhe historitë objektive nuk u janë komunikuar domosdoshmërisht të gjitha palëve, dhe ka pasur përpjekje të kufizuara nga niveli qendror për ta nxitur pajtimin.

Pjesëmarrësit konfirmuan se është ndërmarrë punë për trajtimin e së kaluarës dhe drejtësinë tranzicionale, si në nivelin themelor, nga OJQ-të dhe shoqëria civile, ashtu edhe përmes organizatave ndërkombëtare. Disa pjesëmarrës dhe anëtarë të këtyre organizatave mendojnë se

jo gjithmonë e komunikonin mirë punën e tyre dhe se nëse nuk bëhej komunikim, duket sikur asgjë nuk është bërë. Kjo lidhet me veprimtarinë e drejtësisë tranzicionale, por edhe me procedurat gjyqësore. Pjesëmarrësit vunë në dukje se institucionet qendrore dhe lokale i kanë ndërmarrë disa procese të ballafaqimit me të kaluarën, por kanë qenë me fushëveprim të kufizuar. Pjesëmarrësit i theksuan aspektet rajonale të çështjes së ballafaqimit me të kaluarën, dhe vunë në dukje se tekta në Kosovë është i nevojshëm një proces kombëtar dhe sistematik, disa aspekte që e pengojnë pajtimin, siç janë personat e zhdukur ose mungesa e drejtësisë, përmbajnë elemente rajonale që nuk janë adresuar plotësisht.

Pjesëmarrësit në punëtori e pranuan çështjen e pazgjidhur të statusit të Kosovës si një faktor strukturor. Ndërkohë që çështja e statusit të pazgjidhur të Kosovës prek komunitete të ndryshme, pjesëmarrësit e kuptuan që kjo kishte implikime negative në të gjitha komunitetet. Pjesëmarrësit gjithashtu ranë dakord që liderët politikë duket se e mbështesin status quo-në, pasi që e përdorin situatën aktuale për ta legjitimuar pushtetin. Shumica e pjesëmarrësve gjithashtu ranë dakord që udhëheqësit politikë nuk janë parë që ta përmirësojnë kohezionin në Kosovë, dhe si të tillë e legjitimojnë dhe e forcojnë narrativën ekzistuese të konfliktit. Pjesëmarrësit vunë në dukje gjetjet e raportit mbi mosbesimin politik në nivelin lokal dhe qendror ndaj lidhshimit politik dhe ranë dakord se kjo tregon se liderët politikë nuk i përfaqësojnë pikëpamjet ose nevojat e qytetarëve. Kjo, nga ana tjetër, vazhdon mungesën e besimit në institucionet dhe shërbimet publike. U konfirmua se ekziston një perceptim se liderët politikë janë të shqetësuar për çështje të mëdha, si integrimi në BE dhe liberalizimi i vizave, në vend të çështjeve që i prekin individët çdo ditë, siç janë arsimiti, shërbimet sociale dhe punësimi.

Në të trija temat e identifikuar përmes punëtorive dhe të përshkruara në raport; lidhshimi politik, stagnimi në raport me ekonominë, qeverisja dhe shërbimet sociale, si dhe mundësia e bashkimit për ndryshime, disa pjesëmarrës vunë në dukje se ata gjithmonë i kishin konsideruar këto çështje si çështje strukturale, dhe ishin të befasisur kur e panë mungesën e ballafaqimit me të kaluarën dhe me çështjen e statusit të Kosovës si faktorë strukturorë. Kjo i atribuohet faktit se ballafaqimi me të kaluarën dhe çështja e statusit të Kosovës ende paraqesin çështje që janë të dhimbshme për t'u adresuar, dhe shpesh janë shumë të politizuara. Kjo ka rezultuar në diskutimin për kohezionin social dhe parandalimin e konflikteve duke u përqendruar në çështje që lidhen me papunësinë dhe arsimin, të cilat raporti i identifikoi si tema/simptoma të çështjeve strukturale të mungesës së ballafaqimit me të kaluarën ose çështjes së statusit të pazgjidhur të Kosovës.

Disa pjesëmarrës thanë që të kërkohet shumë më tepër diskutim për këto çështje, konkretisht për ballafaqimin me të kaluarën, dhe se kjo do të ishte mënyra e vetme për të bërë përparim. Ndërkohë që kishte debate se si të vazhdohej më së miri me ballafaqimin me të kaluarën dhe si duhet të duket ky proces, në përgjithësi, të gjithë pjesëmarrësit ranë dakord se kërkohet një proces ballafaqimi me të kaluarën.

Kur i diskutuan pikat hyrëse të kohezionit social të mediave dhe sektorit të drejtësisë, pjesëmarrësit ranë dakord që këto ishin pika të mundshme hyrëse për kohezion të mëtejshëm social, por gjithashtu bënë thirrje për kujdes në lidhje me të dyja temat. Për mediat, rezultati kryesor i diskutimit është se komunikimi është thelbësor për kohezionin social. Siç u përmend më herët në raport, nëse rezultatet ose puna nuk i komunikohen mirë publikut, ato zëre se nuk ekzistojnë. U shpreh se mediat, si mediat tradicionale ashtu edhe ato sociale, mund të përdoren për ta nxitur kohezionin social, por OSHC-ve/OJQ-ve shpesh nuk u jepet hapësirë në mediat tradicionale. Për mediat tradicionale, siç janë gazetat, u ngritën disa shqetësime në lidhje me raportimin etik, pasi mediat tradicionale shpesh varen nga financimi i shtetit. Mediat e financuara nga shteti kanë një shtrirje më të madhe publike, shpesh duke e formuar opinionin publik. Për mediat sociale, u ngritën shqetësimet për lajmet e rreme dhe mungesën e kontrollit. Sipas

pjesëmarrësve, mediat gjithashtu përdoren shpesh për ta përjetësuar narrativën e konfliktit dhe për të nxitur urrejtje. Pjesëmarrësit vunë në dukje se mediat kanë potencial për kohezion të mëtejshëm social, por kërkohet trajnimi për gazetarët dhe mekanizmat mbikëqyrës.

Pjesëmarrësit, duke i bërë dallimet e ndryshme, siç janë çështja e lëndëve të mbetura e të vonuara, mungesa e zbatimit ligjor dhe mungesa e profesionalizmit, e validuan edhe sektorin e drejtësisë si një pikë hyrëse për kohezionin social. U vu në pah se ndërkohë që ligjet janë të zhvilluara mirë dhe të shkruara mirë, çështja e zbatimit është problem për të gjitha komunitetet. Si shembuj të ligjeve të shkruara mirë që nuk po zbatoheshin plotësisht u ngritën disa herë ligji për barazinë gjinore dhe ligji për gjuhët zyrtare.

Çështja e gjuhës u ngrit në disa raste dhe në raport me shumë aspekte, si në politikë ashtu edhe në media, si dhe narrativat e konfliktit dhe sektori i drejtësisë. Pjesëmarrësit nga të dyja komunitetet menduan se gjuha ishte një faktor pengues për kohezionin social. Brezi i ri shpesh nuk mund të komunikojë me anëtarët e komunitetit tjetër, çka e bën të vështirë diskutimin e çështjeve të vështira dhe narrativave të kaluara, por çështja është shumë më e thellë se ajo e përkthimit dhe ligjit për gjuhët zyrtare. Ndërkohë që të gjitha dokumentet publike duhet të jenë të disponueshme dhe të siguruara në gjuhën shqipe dhe serbe, pjesëmarrësit vunë në dukje se shpesh nuk është kështu. Pjesëmarrësit folën hapur për përkthimin e keq të disa ligjeve, vendimeve gjyqësore dhe mungesën e shërbimeve komunale të disponueshme në gjuhë të caktuara, dhe që ky është një faktor i rëndësishëm që e pengon kohezionin social. Pjesëmarrësit deklaruan se shpesh nuk ka përkthyes të trajnuar të mjaftueshëm, pasi që ata që janë më të mirë priren të shkojnë në sektorin privat ose në organizata ndërkombëtare, dhe se përkthimi nuk bëhet profesionalisht. Ata kërkuan që personeli i përkthimit, veçanërisht në nivelin komunal dhe qendror, të profesionalizohet më tej dhe që dokumentet të kontrollohen për cilësi përpara se të bëhen publike. Edhe kurset e gjuhëve, veçanërisht për të rinjtë, u përmendën disa herë, dhe teksa ka disa që tashmë ekzistojnë, dukej se kishte më shumë kërkesa në krahasim me atë se çfarë ofrohet. Duhet të theksohet se raporti që buron nga Forumi i Ndërtimit të Mirëbesimit të UNMIK-ut, i cili u mbajt në Lubjanë më 6-8 maj 2018, e thekson pajtueshmërinë gjuhësore si gjashtë rekomandimet e para që dalin nga grupi për Qeverisje të Mirë dhe Qasje në Shërbime.⁹⁴

Ndërkohë që gratë dhe të rinjtë u validuan si aktorë konstruktivë për kohezionin social, mungesa e përfaqësimit të tyre në kuadër të sferës politike u diskutua si pengesë për kontributin e tyre të plotë.

Sektori i biznesit u identifikua si një pikë e tretë e mundshme hyrëse për kohezionin social. Ndërkohë që sektori i biznesit dhe shkëmbimi ekonomik ka ekzistuar gjithmonë në mes të të gjitha komuniteteve, u sugjerua që kjo të hulumtohet më tej, si dhe nëse disa nga këto modele të biznesit mund të përdoren për ta nxitur dhe për ta rritur kohezionin social.

Informatat shtese (inputet) te metejme

UNHCR-ja ka sugjeruar që për ta rritur kohezionin social duhet të promovojmë pjesëmarrje kuptimplotë të të kthyerve vullnetarë, personave të zhvendosur, personave në rrezik të pa shtetësisë, refugjatëve dhe komuniteteve të marginalizuara, në programet e zhvillimit me fokus specifik në sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës, punësimit, mundësive ekonomike dhe profesionale. Në mënyrë të veçantë, duhet të përqendrohet në 400 persona të vendosur në

⁹⁴ Raporti i Forumit (2018) Forumi i Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Mirëbesimit në Kosovë, i qasur në prill 2019 nga: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/un_kosovo_trust-building_forum_2018_final_report.pdf.

Strehimoret Kolektive në rajonet e Gjilanit, Mitrovicës dhe Prishtinës. Si rezultat i nismave të bashkëjetesës, për kategoritë e mësipërme, bazuar në nevojat e tyre, duhet të ekzistojnë mundësi të barabarta për integrim dhe projekte të zhvillimit të komunitetit, si për pjesën tjetër të qytetarëve. Në fushat e strehimit, tokës dhe pronës, UNHCR-ja vazhdon të inkurajojë zgjidhje adekuate të strehimit përmes mundësive të zgjedhjeve kuptimplotë të personave të zhvendosur për të arritur zgjidhje të qëndrueshme.

Shembuj të ndryshëm të mekanizmave tashmë ekzistues që e rrisin kohezionin social u dhanë nga ekipi i UNKT-së, siç janë Fondacioni IPKO, veçanërisht DokuTech, Dokufest, Thermokiss, Prishtina Hackerspace (kurse të gjuhëve falas), FLOSK, Fusha Multietnike e Tenisit në Çagllavicë dhe Rock Shkolla në Mitrovicë.

SHTOJCA 4 - AGJENDA E PUNËTORISË PËR VËRTETIM TË GJETJEVE



Empowered lives.
Resilient nations.

Agjenda Kohezioni Social në Kosovë: Identifikimi i Nxitësve të Konfliktit dhe Shtigjeve të Reagimit të Mundshëm Faza II

VENDI: Hotel Sirius, Agim Ramadani, Prishtinë

(E martë, 02 prill 2019)

08:45- 09:00	
08:45- 09:00	Arritja dhe regjistrimi
09:00- 09:30	Mirëseardhja dhe fjalët hyrëse <ul style="list-style-type: none">Znj. Marta K. Gazideda, Menaxhere e Portfolios për Qeverisjen dhe Ndërtimin e Paqes/Zëvendës Koordinatore e Programit në UNDP në KosovëZnj. Helena Vazquez, Akademia Folke Bernadotte
09:30-10:00	Prezantimi i raportit përfundimtar për 'Kohezionin Social në Kosovë' <ul style="list-style-type: none">Gjetjet kyçe
10:00-11:45	Diskutim i moderuar <ul style="list-style-type: none">Informata të përgjithshme kthyesë mbi gjetjetReagimi ndaj elementeve kyçe të kornizës konceptuale të kohezionit socialQartësimi i pikave hyrëse të identifikuara përmes hulumtimit
11:45-12:00	Përmbledhje dhe mbyllje